



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT VENDIM

Nr. ___ datë ___ / ___ 2026

PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË BUXHETIT DHE VLERËSIMIN E
PËRGJITHSHËM FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-PRILL 2026, BASHKIA PËRMET

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 48 " Monitorimi dhe zbatimi i buxhetit vendor", Ligji nr.87/2025 datë 12.12.2025 "Pwr buxhetin e vitit 2026", Udhëzim nr.2 datë 14.01.2026 'Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026" Udhëzim nr.35 datë 29.12.2023 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetqeverisjes vendore", Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin e monitorimit të Buxhetit dhe vlerësimin e përgjithshëm financiar , për periudhën 4-mujore, viti 2026, për Bashkinë Përmet.
2. Ky vendim shpallet menjëherë dhe hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA





**RAPORT I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË
BUXHETIT 4M VITI 2026
BASHKIA PËRMET**

Maj 2026



REALIZIMI I TE ARDHURAVE TE BASHKISË PËR 4 M E VITIT 2026

REALIZIMI I BUXHETIT PËR 4 M E VITIT 2026

PROGRAMI AA135 : PLANIFIKIM DHE MENAXHIM

PROGRAMI AB135 : SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNITARE DHE INFRASTRUKTURA

PROGRAMI AC135: ARSIMI DHE KUJDESI SOCIAL

PROGRAMI AD135: ARGËTIM DHE ZHVILLIM

PROGRAMI AE135: SIGURIA E QYTETARIT DHE MBROJTJA E MJEDISIT

PROGRAMI AF135: REZERVA DHE KONTIGJENCA

MINISTRITË E LINJËS

PROJEKTE

VLERËSIMI I SITUATËS FINANCIARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. Prot.

Përmet, më .05.2026

Lënda : Monitorimi i realizimit të buxhetit të 4- mujorit të parë, për vitin 2026 dhe vlerësimi i situatës financiare

Drejtuar:MINISTRISË SË FINANCAVE

TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.87 datë 12.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026", mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 9 datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimi nr.2, datë 14.01.2026, Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026 si ligjin nr 68/2017 date 27.4.2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " të ndryshuar, ligjin nr. 10296 date 8.7.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, VKB nr.100,datë 04.12.2026,"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore viti 2026" VKB nr. 113,datë 17.12.2025," "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026" i ndryshuar po ju paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën e 4-mujorit të parë viti 2026.

Bashkia Përmet administron dhe menaxhon fondet publike në përputhje me programet buxhetore, në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2025, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026–2028". Zbatimi bazohet në Shtojcën nr. 5 të këtij udhëzimi, e cila përcakton "Metodologjinë e re të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028 dhe Buxhetit 2026" për bashkitë: Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak, Belsh, Fier, Patos, Fushë Arrëz, Skrapar, Mat, Delvinë dhe për qarqet: Shkodër, Gjirokastrë dhe Korçë.

Në këtë kuadër, struktura e programeve të buxhetit vendor të Bashkisë Përmet do të paraqitet si më poshtë:

Bashkia Përmet (135)

<i>Kod</i>	<i>Emërtimi</i>
AA135	Planifikim dhe Menaxhim
AB135	Shërbimet Publike Komunitare dhe Infrastruktura
AC135	Arsimi dhe Kujdesi Social
AD135	Argëtim dhe Zhvillim
AE135	Siguria e Qytetarit dhe Mbrojtja e Mjedisit
AF135	Rezerva & Kontigjenca



Buxheti vjetor fillestar për vitin 2026 ishte në shumën 517,256 mijë lekë. Për periudhën janar-prill, planifikimi i shpenzimeve ishte 280,648 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik i shpenzimeve rezultoi 134,909 mijë lekë, që përbën 48 % të planit të kësaj periudhe. Niveli i realizimit në këtë katërmujor është ndikuar nga disa faktorë kryesorë. Së pari, vonesat në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik kanë penguar nisjen në kohë të disa zbatimeve, veçanërisht në sektorët që përfshijnë investime kapitale. Së dyti, është evidentuar një planifikim disproporcional i shpenzimeve në katërmujorin e parë të vitit, ku një përqindje më e lartë e buxhetit është parashikuar të realizohej gjatë kësaj periudhe, duke mos qenë në përputhje me ritmin real të përgatitjes dhe zbatimit të projekteve. Këto dy faktorë së bashku kanë ndikuar në mosrealizimin e pritshëm të buxhetit për katërmujorin e parë dhe kërkojnë rishikim të ritmeve të planifikimit dhe zbatimit në muajt në vijim.

REALIZIMI I TË ARDHURAVE PËR PERIUdhËN JANAR - PRILL 2026

NR	LLOJI I TE ARDHURAVE	PLANI		
		VJETOR	Plani Prill	Fakti Prill 2026
A	TE ARDHURA TATIMORE	37492	12692	11129
1	Taksa mbi ndertesat	12795	4984	4271
2	Taksë mbi truallin	1551	573	760
3	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	0	0	8
4	Takse e ndik.infr.nd.reja dhe legalizimet	7000	1600	797
5	Takse mbi kalimin e te drejtes se prones.	200	0	0
6	Takse Rregjistrim automjeti	6200	2972	2338
7	Takse Tabele	623	300	813
8	Taksë mbi tokën bujqësore	3623	975	1373
9	Taksë fjetje në hotel	1000	210	364
10	Tatim mbi të ardhurat personale	4500	1078	405
				0
B	TE ARDHURA JOTATIMORE	52943	17452	16677
1	Tarife Pastrimi	23871	5830	9386
2	Tarife Ndricimi	5790	2252	2462
3	Tarife Gjelberimi	2950	1355	1447
4	Leje Rregjistrim Veprimtarie	600	300	228
5	Qera toke bujqesore	396	150	177
6	Te ardhura nga kopeshti dhe cerdhja	2693	900	386
7	Tarife Parkimi	150	100	45
8	Tarifë për lëndë drusore	1161	211	333
9	Tarifë zënie hapësirë publike	907	707	314
10	Tarifë kullotje bagëtiye	2500	1375	75
11	Tarifë mirëmbajtje kanale vaditës	300	30	3
12	Të ardhura nga ndermarret dhe pronesia	7425	2452	1485
13	Tarifa vendore nga urbanistika	4000	1590	211



14	Tarifa shërbimesh të MNZ	200	200	
15	Takse vendore uji			42
16	Te tjera te ardhura			26
17	Certifikate perdorimi			
18	Tarife vendore per shqyrtim ose nxjerje dosje			15
19	Qera toke bujqesore			0
20	sekuestrime e gjoba			15
21	sponsorizime			
22	takse shitje pasurie			27
	Të ardhura viti 2026	90435	30144	27806

Krahasuar realizimi i vitit 2026 me vitin 2025 paraqitet si më poshtë:

N R	LLOJI I TE ARDHURAVE	PLANI		Fakt i Prill 2026	Fakt i Prill 2025	Diferen ca	%
		VJET OR	Plani Prill				
A	TE ARDHURA TATIMORE	37492	12692	1112	1075	377	103.5
1	Taksa mbi ndertesat	12795	4984	4271	5382	-1111	79.4
2	Taksë mbi truallin	1551	573	760	881	-121	86.3
3	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	0	0	8	10	-2	80.0
4	Takse e ndik.infr.nd.reja dhe legalizimet	7000	1600	797	584	213	136.5
5	Takse mbi kalimin e te drejtes se prones.	200	0	0	80	-80	0.0
6	Takse Rregjistrim automjeti	6200	2972	2338	2285	53	102.3
7	Takse Tabele	623	300	813	268	545	303.4
8	Taksë mbi tokën bujqësore	3623	975	1373	843	530	162.9
9	Taksë fjetje në hotel	1000	210	364	12	352	
10	Tatim mbi të ardhurat personale	4500	1078	405	399	6	101.5
				0	8	-8	0.0
B	TE ARDHURA JOTATIMORE	52943	17452	1667	1694	-268	95.6
1	Tarife Pastrimi	23871	5830	9386	6541	2845	161.0
2	Tarife Ndricimi	5790	2252	2462	1579	883	109.3
3	Tarife Gjelberimi	2950	1355	1447	1126	321	106.8



	Leje Rregjistrim Veprimtarie	600	300	228	406	-178	76.0
5	Qera toke bujqesore	396	150	177	16	161	0.0
6	Te ardhura nga kopeshiti dhe cerdhja	2693	900	386	563	-177	42.9
7	Tarife Parkimi	150	100	45	32	13	45.0
8	Tarifë për lëndë drusore	1161	211	333	639	-306	157.8
9	Tarifë zënie hapësirë publike	907	707	314	1134	-820	44.4
10	Tarifë kullotje bagëtije	2500	1375	75	222	-147	5.5
11	Tarifë mirëmbajtje kanale vaditës	300	30	3	21	-18	10.0
12	Të ardhura nga ndermarret dhe pronesia	7425	2452	1485	1433	52	60.6
13	Tarifa vendore nga urbanistika	4000	1590	211	1542	-1331	13.3
14	Tarifa shërbimesh të MNZ	200	200		30	-30	0.0
15	Takse vendore uji			42	116	-74	
16	Te tjera te ardhura			26	7	19	
17	Certifikate perdorimi				152	-152	
18	Tarife vendore per shqyrtim ose nxjerje dosje			15	40	-25	
19	sekuestrime e gjoba			15	508	-493	
20	sponsorizime				838	-838	
21	takse shitje pasurie			27		27	
22							
						0	
	Të ardhura viti 2026	90435	30144	2780 6	2769 7	109	92.2



Realizimi i të ardhurave për periudhën raportuese Janar- Prill,viti 2026,sic shihet dhe nga tabela e mësipërme është në vlerën 27,806,000 lekë ose 2,338,000 lekë më pak se plani i periudhës raportuese.

Diferencat ne mosrealizim kanë ardhur kryesisht në këtë zëra.

- 1- Mos dhënia për përdorim e hapësirave publike si rezultat i ndryshimit të legjislacionit per dhenien dhe përdorimin e hapësirave publike.
- 2- Taksa e ndikimit në infrastrukturë,kjo përlogaritur plani i periudhës raportuese sipas të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.
- 3- Të ardhurat personale ishin përlogaritur në planifikim me të njëjten periudhë të vitit të kaluar.
- 4- Tarifa e urbanistikës ishte përlogaritur planifikimi duke u bazuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Po kështu në tabelë paraqitet dhe ndryshimi viti 2026 në realizim dhe viti 2025.

I shprehur në përqindje ky realizim krahasuar me planin 4- mujor është 92.2 %

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar janë gumbulluar pak a shumë në mënyrë të barabartë taksat dhe tarifatat vendore..

Për vitin 2026 janë aktiv 523 biznese dhe 22 institucione.

Kanë mbyllur aktivitetin 3 biznese ,kryesisht biznes i madh 1 ,biznes i vogel 2 .

Janë hapur gjithsej 6 biznese,kryesisht 5 biznese të vegjël.,1biznes i madh.

Përmendim se gjatë kësaj periudhe nuk janë pasqyruar në raportim të ardhurat e mbledhura nga SHA Ujësjellës muaji mars ne shumen 1,845,174 leke .Detyrimisht niveli i të ardhurave në periudhën raportuese do të ishte akoma më i lartë.

Gjatë kësaj periudhe është bashkëpunuar me Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve Gjirokastër si Agjent Tatimor, për derdhjen në kohë të të ardhurave të grumbulluara nga popullata Detyrimi vjetor i të ardhurave për popullatën është shpërndar në 10 muaj. Arkëtimet nga ujësjellësi gjatë kësaj periudhe kanë qënë në vlerën 9,695,596 lekë ,kundrejt planit të periudhës vjetore 19,388,251 lekë.

Nga Sektori i Tatim Taksave,Aseteve dhe Licencave është punuar maksimalisht për realizimin e të ardhurave të periudhës raportuese dhe njëkohësisht për të grumbulluar të ardhura nga detyrimet e prapambetura për të ulur borxhin tatimor.


Në muajin Janar të vitit 2026,specialistët e këtij sektori me daljet e tyre në terren bënë të mundur të vilnin taksën e fjetjes në hotel për hotelet dhe guest hauset, e cila u verifikua në muajin Dhjetor 2025,në vlerën 363,525 lekë. Kanë paguar 36 subjekte.

Për periudhën që raportojmë kanë shlyer detyrimet e prapambetura,rreth 17 subjekte,në vlerën 562,684 lekë,këto pagesa janë për periudhën 2015-2025.

Sfidë për ne ngelet ulja e borxhit tatimor,sistemimi i taksës së pasurisë,kjo si për ndërtesat, tokën bujqësore ,truallin,por edhe vënia në efencë e asetëve të Bashkisë Përmet .



REALIZIMI I TË ARDHURAVE



- Taksa mbi ndertesat
- Takse mbi truallin
- Tatim i thjeshtuar mbi fitimin
- Takse e ndikimfr. nd. reja dhe legalizimet
- Takse mbi kalimin e te drejtes se prones.
- Takse Rregjistrim automijeti
- Takse Tabele
- Takse mbi tokem bujqesore
- Takse fjerje ne hotel



Paraqitja e realizimit të shpenzimeve për periudhën katërmujore të parë të vitit pasqyrohet si më poshtë:

Nr	Struktura		
		Plani vjetor	Fakti
1	Aparati I Bashkise (00.1110.01)	89,271,085	32,358,708
	Total AA 135	89,271,085	32,358,708
1	Bordi I kullimit (00.4240.01)	20,518,553	2,978,576
2	Sherbimi pyjor (00.4260.01)	17,284,046	5,189,999
3	Rruget rurale (00.4520.01)	40,582,637	8,817,517
4	Pastrim (00.5100.01)	55,109,992	13,209,406
5	Gjelberim ,Brigada (00.6260.01)	37,378,803	13,642,882
6	Sepac (00.6260.01)	4,323,000	-
	Total AB 135	175,197,031	43,838,380
1	Arsimi (00.09120.01)	49,972,762	13,773,701
2	Konvikti(00.9230.01)	13,609,000	-
3	Shk.Mesame(00.9230.01)	8,743,645	1,809,451
4	Cerdhja (00.10430.01)	8,737,427	2,150,827
5	Perfshirje (00.10430.01)	13,520,837	3,590,993
6	RIWET (00.10430.01)	4,840,000	2,526,805
	Total AC 135	99,423,671	23,851,777
1	Kultura (00.08220.01)	27,053,750	4,668,974
2	EURBAN DECO (00. 8220 .01)	400,000	399,844
3	Sporti (00.8130.01)	14,266,000	-
	Total AD 135	41,719,750	5,068,818



1	Zjarrfikset (00.3280.01)	31,623,314	6,957,769
2	Mbrojtja e konsumatorit (00.3280.01)	4,869,000	1,346,740
3	Policia (00.3140.01)	9,747,000	2,767,624
	Total AE 135	46,239,314	11,072,133
1	Fond rezerve (00.4940.01)	3,181,000	305,000
	Total AF 135	3,181,000	305,000
	TOTALI KAP 1	455,031,851	116,494,816
1	AB135 SEPAC (skeme e pjesshme thesari) (6260.02)	34,409,000	-
2	AD135 URBACT (8220.02)	982,000	971,352
3	AC135 RIWET (10430.02)	5,400,000	-
4	AB135 Projektimi i Rehabilitimit Lagjja e Re (4520.02)	3,777,716	-
	TOTAL KAP 2	44,568,716	971,352
1	Aparati i Bashkise (1110.05)	27,820,000	919,656
	Total AA 135	27,820,000	919,656
1	Bordi i kullimit (4240.05)	2,000,000	339,797
2	Sherbimi pyjor (4260.05)	-	-
3	Rruget rurale (4520.05)	34,444,243	9,002,375
4	Pastrim (5100.05)	5,000,000	1,710,868
5	Gjelberim ,Brigada (6260.05)	12,000,000	3,878,168
	Total AB 135	53,444,243	14,931,208
1	Arsim parashkollor (9120.05)	389,697	389,697
2	Perfshirje (10430,05)	8,055,000	-
	Total AC 135	8,444,697	389,697
1	Kultura (8220.05)	2,500,000	951,882
2	Sporti (00.8130.05)	3,859,000	-




	Total AD 135	6,359,000	951,882
1	Mnz (3280.05)	50,000	-
2	Policia (3140.05)	1,200,000	-
	Total AE 135	1,250,000	-
1	Fond rezerve (4940.05)	1,810,000	250,000
	Total AF 135	1,810,000	250,000
	TOTALI KAP 5	99,127,940	17,442,443
	SHUMA GJITHESEJ	598,728,507	134,908,611

Plani dhe realizimi i shpenzimeve të paraqitura në tabelën e mësipërme janë rakorduar me Degën e Thesarit. Realizimi i shpenzimeve për periudhën katërmujore është mbuluar nga të ardhurat e Bashkisë, të cilat janë pasqyruar në tabelën e fondeve për kapitullin 05, si dhe nga fondet e siguruara përmes Transferteve të pakushtëzuara dhe transfertave të kushtëzuara sektoriale, të cilat janë reflektuar në kapitullin 01 të tabelës së fondeve. Me siper pasqyrohen dhe fondet me kapitull 02 me skemë të plotë thesari dhe me skeme të pjesshme thesari. Në këtë periudhë, realizimi i shpenzimeve ka arritur në nivelin 23% në raport me planin vjetor dhe 48% në krahasim me planin për periudhën raportuese.



REALIZIMI VJETOR PLAN FAKT





I. Programi AA135 "Planifikim dhe menaxhim"

Ky program mbulon funksionin bazë dhe mbështetës të administratës së bashkisë, duke përfshirë strukturat që sigurojnë organizimin, ndjekjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së përditshme institucionale. Ai përfshin gjithashtu veprimtarinë e këshillit bashkiak, trajnimet e stafit dhe çështje që lidhen me detyrime ligjore apo administrative.

Realizimi i shpenzimeve për katërmujorin e parë të vitit 2026 për këtë program përfaqëson 28 % të planifikimit total vjetor. Në analizë krahasuese me planin e katërmujorit, realizimi sipas zërave kryesorë paraqitet si më poshtë:

- ✓ shpenzimet korrente janë realizuar në masën 52 % ndaj buxhetit të planifikuar për katërmujorin e parë
- ✓ shpenzimet kapitale rezultojnë në një nivel minimal prej vetëm 5%.

Ky tregues evidenton një ritëm shumë të ulët të realizimit të investimeve të planifikuara për këtë periudhë.

Për vitin 2026, janë parashikuar 3 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të realizuara si më poshtë.

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Kapacitetet menaxhuese dhe implementuese të institucioneve të trajnuara dhe të mirëfunksionuara për hartimin dhe monitorimin e politikave.	88,954	30,312	26,469	87	pjesërisht
Shpenzime kapitale	4,955	610	30	5	
Procedura pune të realizuara, materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre, shpenzime transporti, udhëtimi brenda dhe jashtë vendit, si dhe shpenzime të tjera operative, në funksion të aktiviteteve të institucionit.	23,182	12,952	6,780	52	pjesërisht



TOTALI

117,091

43,874

33,279

76

Siç paraqitet në tabelë, ky program përfshin tre produkte kryesore: pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit të Bashkisë, shpenzimet e përgjithshme operative dhe shpenzimet kapitale. Realizimi i shpenzimeve për secilin prej këtyre produkteve është rakorduar me Degën e Thesarit Përmet. Niveli i mosrealizimit për këtë katërmujor është rezultat i planifikimit të fondeve në përputhje me përqindjen e çeljes së miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

2- Programi ABI35 “ Shërbime Publike Komunitare dhe Infrastruktura ”

Politikat në fushën e zhvillimit të komunitetit kanë konsistuar kryesisht në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e hapësirave publike dhe mjediseve të përbashkëta. Aktivitetet kanë përfshirë gjelbërimin e ambienteve publike, mirëmbajtjen e varrezave, parqeve, lulishteve dhe fidanishtes, si dhe zëvendësimin e trotuareve të dëmtuara. Gjithashtu, është vijuar me ndriçimin e hapësirave publike, dhënieve të lejeve të zhvillimit, planifikimin e territorit, si dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore urbane dhe rurale. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe mirëmbajtjes së sistemeve të ujitjes dhe kullimit, menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, si dhe menaxhimit të mbetjeve urbane dhe rurale.

Për periudhën katërmujore të vitit 2026, realizimi i buxhetit për këtë program për produktet e planifikuara paraqitet në nivelin 22% të totalit të planifikuar vjetor. Në analizë me planin e katërmujorit, realizimi sipas zërave kryesorë evidentohet si më poshtë:

- ✓ shpenzimet korrente janë realizuar në masën 42 %
- ✓ shpenzimet kapitale rezultojnë në një nivel minimal prej vetëm 22 %

Në tërësi, realizimi i programit gjatë katërmujorit të parë të vitit 2026 vlerësohet i kënaqshëm për sa i përket shpenzimeve të personelit, të cilat kanë ndjekur ritmin e planifikimit. Nga ana tjetër, realizimi i ulët i shpenzimeve kapitale ka ndikuar në nivelin e përgjithshëm të realizimit të programit. Kjo situatë evidenton nevojën për intensifikimin e procedurave të prokurimit, zbatimit dhe likuidimit të projekteve investuese gjatë muajve në vijim, me qëllim përmbushjen e objektivave dhe treguesve të planifikuar në buxhetin vjetor 2026.



mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Realizimi faktik i 4- mujorit I 2026			
		Buxheti 4 mujor	Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	114,233	41,344	37,272	93	pjeserisht
Shpenzime kapitale	102,983	66,714	14,790	22	pjeserisht
Procedura pune te realizuara / Materiale dhe sherbime te pergjitheshme zyre, shpenzime transporti, dhe te tjera operativeper mirembajtje ne funksion te aktiviteteve te institucionit.	49,612	15,987	6,708	42	pjeserisht
TOTALI	266,828	124,045	58,770	48	

Pjesë e Programit AB 135 janë pesë funksione kryesore, të cilat përfaqësojnë fusha të rëndësishme ndërhyrjeje në mbështetje të komuniteteve dhe zhvillimit të qëndrueshëm vendor. Në vijim, secili prej këtyre funksioneve do të analizohet në mënyrë të veçantë në këtë raport , në funksion të vlerësimit të realizimit buxhetor dhe ndikimit të tyre konkret në përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës në njësitë përkatëse.

- ❖ **Funksioni “Rrjeti rrugor rural”** si pjesë e programit AB135 synon mirëmbajtjen, ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve dhe urave në zonat rurale, me qëllim përmirësimin e aksesit dhe mbështetjen e komuniteteve lokale. Ky funksion kontribuon drejtpërdrejt në lehtësimin e lëvizjes, zhvillimin ekonomik dhe lidhjen më të mirë të zonave të thella me qendrat urbane.

Për periudhën katërmujore të vitit 2026, realizimi i buxhetit për këtë program për produktet e planifikuara paraqitet në nivelin 22% të totalit të planifikuar vjetor. Në analizë me planin e katërmujorit, realizimi sipas zërave kryesorë evidentohet si më poshtë:

- ✓ **shpenzimet korrente janë realizuar në masën 64%**



mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Realizimi faktik i 4- mujorit I 2026			
		Buxheti 4 mujor	Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	27,986	9,725	8,448	87	pjeserisht
Shpenzime kapitale	48,178	41,578	8,682	21	pjeserisht
Procedura pune te realizuara / Materiale dhe sherbime te pergjitheshme zyre, shpenzime trasporti, dhe te tjera operativeper mirembajtje ne funksion te aktiviteteve te institucionit.	2,641	1,073	690	64	pjeserisht
TOTALI	78,805	52,376	17,820	34	

- ❖ **Funksioni “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”** ka si qëllim mirëmbajtjen, administrimin dhe funksionimin e qëndrueshëm të rrjeteve ujitëse dhe kulluese në territorin e Bashkisë. Ky funksion synon të sigurojë përmirësimin e kushteve për aktivitetin bujqësor, parandalimin e përmytjeve dhe rritjen e eficiencës në përdorimin e burimeve ujore. Ndërhyrjet përfshijnë pastrimin e kanaleve, rehabilitimin e segmenteve të dëmtuara dhe monitorimin periodik të rrjetit, në funksion të përmirësimit të shërbimeve ndaj komunitetit bujqësor dhe ruajtjes së tokave bujqësore nga degradimi.

Realizimi i shpenzimeve për funksionin “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit” gjatë katërmujorit të parë të vitit 2026 paraqitet në nivelin 15% të buxhetit vjetor të planifikuar për këtë funksion. Në raport me planin vjetor dhe 4-mujor, realizimi sipas zërave kryesorë financiare rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit



Paga e sig.shoqërore	5725	2050	1727	84	pjeserisht
Shpenzime kapitale	11,706	2113	889	42	pjeserisht
Procedura pune te realizuara ne funksion te aktiviteteve te institucionit.	5088	3022	703	23	pjeserisht
TOTALI	22,519	7,185	3,319	46	

Siç pasqyrohet edhe në tabelë, ky funksion përfshin tre produkte kryesore: pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e Bordit të Kullimit, shpenzimet operative për funksionimin e sektorit, si dhe shpenzimet kapitale që lidhen me realizimin e projekteve investuese në fushën e ujitjes dhe kullimit. Ndër projektet kryesore të financuara gjatë kësaj periudhe përfshihen kanali vaditës i Rrapckës, sistemi vaditës për fshatin Kotal dhe ish-SMT, shërbimet e mbikëqyrjes, kolaudimit, oponencës teknike dhe VNM-së, rezervuari i Qilarishtit, si dhe oponenca teknike për Lotin I dhe Lotin II të projektit të Përroit të Bardhë. Realizimi financiar i këtyre produkteve është rakorduar me Degën e Thesarit Përmet, duke garantuar përputhshmëri të plotë me procedurat dhe kërkesat e zbatimit buxhetor.

- ❖ **Funksioni i “Menaxhimit të mbetjeve”** ka për qëllim organizimin, kontrollin dhe përmirësimin e shërbimeve të pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë, përfshirë zonat urbane dhe rurale. Një fokus i veçantë i është kushtuar zonave përgjatë luginës së lumit Vjosë, si dhe vendbanimeve rurale me vlera të larta turistike, të cilat tërheqin vizitorë gjatë gjithë vitit. Ky funksion synon të sigurojë një mjedis të pastër, të qëndrueshëm dhe mikpritës, duke kontribuar në ruajtjen e potencialit natyror dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm. Aktivitetet përfshijnë grumbullimin e mbetjeve, transportin, depozitimin në vende të miratuara, pastrimin periodik të zonave të ndjeshme dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve.

Realizimi i shpenzimeve për funksionin “Menaxhimi i mbetjeve” gjatë katërmujorit të parë të vitit 2026 përfaqëson rreth 25% të buxhetit vjetor të planifikuar për këtë funksion nga Bashkia. Në analizë me planin vjetor dhe planin 4-mujor, realizimi sipas zërave kryesorë të shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

Produkti	Buxheti 2026 në mije lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit I 2026		
			Në Mije lekë	Në %	Statusi i realizimit

mijë lekë



Paga e sig.shoqerore	29,998	10,684	8,849	83	pjeserisht
Shpenzime kapitale	21,741	15,420	5,220	34	pjeserisht
Procedura pune te realizuara , ne funksion te aktiviteve te institucionit.	8,371	4,797	851	18	pjeserisht
TOTALI	60,110	30,901	14,920	48	

Siç pasqyrohet edhe në tabelë, ky funksion përfshin dy produkte kryesore: pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e angazhuar në menaxhimin e mbetjeve, si dhe shpenzimet që lidhen me funksionimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të përdorura në këtë sektor. Investimet e planifikuara në funksionin e menaxhimit të mbetjeve për vitin 2026 synojnë përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e eficiencës së këtij shërbimi. Ndër ndërhyrjet e parashikuara përfshihet blerja e mjeteve për transportin e mbetjeve, kontenierëve dhe koshave të rinj për depozitimin e tyre, me qëllim mbulimin më të mirë të territorit dhe përmirësimin e standardeve të pastrimit. Gjithashtu, janë parashikuar procedura të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe oponencës teknike për projektet, si dhe ndërhyrje për sistemimin dhe pyllëzimin e venddepozitimeve ekzistuese, me synim rehabilitimin mjedisor dhe reduktimin e ndotjes. Këto investime përbëjnë një hap konkret drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit. Realizimi financiar për të dy produktet është rakorduar me Degën e Thesarit Përmet, duke siguruar përputhshmëri të plotë me procedurat zyrtare të zbatimit buxhetor.

- ❖ **Funksioni i “Administrimit të pyjeve dhe kullotave” përfshin një gamë të gjerë veprimesh që lidhen me menaxhimin e qëndrueshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore në administrim të Bashkisë. Qëllimi i këtij funksioni është ruajtja, zhvillimi dhe rigjenerimi i ekosistemeve pyjore dhe kullimore, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e klimës lokale dhe forcimin e qëndrueshmërisë natyrore të territorit. Aktivitetet përfshijnë zbatimin e planeve të menaxhimit për pyjet dhe kullotat, rigjenerimin natyror dhe artificial të pyjeve, pyllëzime në sipërfaqe të degraduara, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve pyjore dhe parcelave kullimore, si dhe ndërhyrje të tjera për mbrojtjen nga erozioni dhe zjarret. Ky funksion ka rëndësi të veçantë edhe për zhvillimin rural dhe promovimin e ekoturizmit në zonat me potencial natyror.**

Realizimi i shpenzimeve të 4-mujorit të parë të vitit 2026, për këtë funksion, përfaqëson rreth 30 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të, krahasuar me planin vjetor rezultojnë si më poshtë:



mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit I 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimi
Paga e sig.shoqërore	11,572	3,975	3,398	85	pjeserish
Shpenzime kapitale	2,610	2,610	0	0	
Procedura pune te realizuara / Materiale dhe sherbime te pergjitheshme zyre, shpenzime transporti, udhetimi brenda dhe jashte vendit dhe te tjera operative, ne funksion te aktiviteteve te institucionit	3,102	1,959	1,791	91	pjeserish
TOTALI	17,284	8,544	5,189	61	

Siç pasqyrohet edhe në tabelë, ky funksion përfshin tre produkte kryesore: pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e Bashkisë, si dhe shpenzime të tjera të përgjithshme që lidhen me funksionimin administrativ të këtij sektori. Realizimi financiar për të gjitha produktet është rakorduar me Degën e Thesarit Përmet, duke garantuar përputhshmëri të plotë me procedurat buxhetore dhe transparencën në zbatimin e fondeve.

- ❖ Funksioni i “Shërbimeve publike vendore” përfshin një sërë aktivitesh të rëndësishme që kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe në krijimin e një mjedisi urban të pastër, funksional dhe estetikisht të këndshëm. Ky funksion mbulon mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra, lulishteve dhe parqeve publike, duke garantuar pastërtinë, rigjenerimin e bimësisë dhe shtimin e hapësirave të gjelbra. Po ashtu, përfshin shërbimin e ndriçimit publik në rrugë dhe sheshe, duke siguruar siguri dhe funksionalitet në jetën e përditshme të komunitetit. Një komponent tjetër i rëndësishëm është mirëmbajtja e infrastrukturës urbane si sheshet, trotualet dhe varrezat publike, të cilat kërkojnë ndërhyrje të vazhdueshme për të ruajtur standardin urban dhe respektin ndaj hapësirave të përbashkëta. Ky funksion luan një rol kyç në estetikën dhe funksionimin e qytetit, veçanërisht në zona me frekuentim të lartë publik dhe turistik.

Realizimi i shpenzimeve të 4-mujorit të parë të vitit 2026, për këtë funksion, përfaqëson



rreth 20 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të, krahasuar me planin vjetor dhe atë 4-mujor rezultojnë si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit I 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimi
Paga e sig.shoqerore	38,952	14,910	14,848	99.5	pjeserish
Shpenzime kapitale	18,748	18,748	0	0	
Procedura pune të realizuara / Materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre, shpenzime transporti, udhëtimi brenda dhe jashtë vendit dhe të tjera operative, në funksion të aktiviteteve të institucionit	30,411	25,780	2,673	10	pjeserish
TOTALI	88,111	59,438	17,521	29	

Siç pasqyrohet edhe në tabelë, ky program përfshin tre produkte kryesore, që lidhen kryesisht me pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit të Bashkisë, si dhe me shpenzime të tjera të përgjithshme të nevojshme për funksionimin e shërbimeve publike. Realizimi financiar i këtyre produkteve është rakorduar plotësisht me Degën e Thesarit Përmet, duke reflektuar zbatim të rregullt dhe në përputhje me planifikimin buxhetor.

3- Programi AC135 "Arsimi dhe kujdesi social".

Ky program synon mbështetjen e arsimit parashkollor dhe arsimit bazë, si dhe administrimin dhe rregullimin efektiv të sistemit arsimor në njësitë përkatëse. Gjatë kësaj periudhe 4-mujore është ndjekur zbatimi i masave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në kopshtet dhe çerdhet publike, përforsimi i kujdesit social në qendrat sociale si edhe garantimi i një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës për fëmijët dhe përfituesit e tjerë të këtyre shërbimeve.

Realizimi i shpenzimeve të 4-mujorit të parë të vitit 2026, për këtë funksion, përfaqëson rreth 21 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Sipas zërave kryesorë të realizuar në 4 mujor, krahasuar me planin 4- mujor, rezultojnë si më poshtë:

Shpenzimet korënte 12 përqind



Realizimi sipas produkteve:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit I 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimi
Paga e sig.shoqërore	66,101	22,244	20,033	90	pjeserisht
Shpenzime kapitale	7,376	6,993	938	13	pjeserisht
Procedura pune të realizuara, në funksion të aktiviteteve të institucionit	39,791	28,171	3,270	12	pjeserisht
TOTALI	113,268	57,408	24,241	42	

Sikurse pasqyrohet edhe në tabelën përkatëse, ky program ofron tre produkte kryesore. Produktet përfshijnë pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin që operon në funksion të këtij programi pranë Bashkisë, si dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme, ku përfshihen kostot për energjinë elektrike, ujin, materialet e kancelarisë dhe pastrimit (detergjentë). Gjithashtu, janë përfshirë edhe shpenzimet për mbështetje sociale, konkretisht pagesat e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë dhe kompensimi me bonus qiraje për këtë kategori. Të gjitha të dhënat financiare dhe shpenzimet e lidhura me këto produkte janë rakorduar dhe konfirmuar nga Degë e Thesarit Përmet.

Pjesë e Programit AC135 janë tre funksione kryesore, të cilat përfaqësojnë shtyllat themelore të ofrimit të shërbimeve në fushën e arsimit, kujdesit social dhe mbështetjes për shtresat në nevojë. Këto funksione lidhen ngushtësisht me garantimin e aksesit në arsim cilësor dhe shërbime sociale të standardizuara, si dhe me sigurimin e një mbështetjeje efektive për familjet e cenueshme.

Në vijim të këtij raporti, secili prej funksioneve do të trajtohet veçmas, me qëllim vlerësimin e realizimit buxhetor dhe analizimin e ndikimit të tyre konkret në përmirësimin e jetës së përditshme të qytetarëve në njësitë përkatëse të Bashkisë.

- ❖ **Funksioni "Arsimi bazë dhe parashkollor" përfshin mbështetjen institucionale dhe financiare për sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë, me qëllim garantimin e një mjedisi mësimor cilësor, të sigurt dhe gjithëpërfshirës për fëmijët e moshave përkatëse. Ky funksion përfshin sigurimin e bazës materiale të nevojshme për funksionimin efikas të institucioneve arsimore, përfshirë shkollat dhe kopshtet,**



furnizimin me mjete didaktike, përmirësimin e infrastrukturës, si dhe mbulimin e shpenzimeve për ushqimin ditor në kopshtet që ofrojnë shërbim me drekë.

Gjatë katërmujorit të parë të vitit 2026, realizimi i shpenzimeve për funksionin "Arsimi bazë dhe parashkollor" ka arritur në 28% të buxhetit të planifikuar vjetor, duke treguar një ritëm të moderuar të zbatimit të buxhetit në këtë periudhë.

Analiza e realizimit të shpenzimeve sipas zërave kryesorë tregon një shpërndarje të ndryshme të fondeve në përputhje me prioritetet dhe nevojat e paraqitura, krahasuar me planin vjetor. Detajimi i shpenzimeve sipas kategorive specifike të funksionit paraqitet si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit I 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	40,010	13,828	11,948	86	pjesërisht
Shpenzime kapitale	1,052	938	938	100	plotësisht
Procedura pune të realizuara, në funksion të aktiviteteve të institucionit	9,301	6,279	1,277	20	pjesërisht
TOTALI	50,363	21,045	14,163	67	

Siç evidentohet edhe nga tabela përkatëse, programi "Arsimi bazë dhe parashkollor" përqendrohet në tre produkte kryesore, të cilat përbëjnë bazën funksionale të shpenzimeve të realizuara gjatë katërmujorit të parë të vitit 2026. Produkti kryesor lidhet me pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin edukativ të kopshteve, që operojnë si në qytetin e Përmetit, ashtu edhe në njësitë administrative përreth. Ky zë përfaqëson një përqindje të konsiderueshme të buxhetit dhe është i domosdoshëm për garantimin e mbarëvajtjes së procesit edukativ në institucionet parashkollore.

- ❖ **Funksioni "Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm"**
Ky funksion përfshin mbështetjen për institucionet e arsimit të mesëm me qëllim garantimin e një mjedisi funksional dhe dinjitoz për nxënësit. Në kuadër të këtij funksioni janë siguruar bazat materiale të nevojshme për funksionimin e rregullt të shkollave me synimin për të krijuar një hapësirë të përshtatshme dhe mbështetëse për të rinjtë.



Realizimi i shpenzimeve të 4-mujorit të parë të vitit 2026, për këtë funksion, përfaqëson rreth 8 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të krahasuar me planin 4 mujor rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit i 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqerore	5,302	1,834	1,563	85	pjeserisht
Shpenzime kapitale	269	0	0	100	
Procedura pune të realizuara / Materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre, shpenzime transporti, udhëtimi brenda dhe jashtë vendit dhe të tjera operative, ne	16,782	16,052	247	2	pjeserisht
TOTALI	22,353	17,886	1,810	10	

Sikurse pasqyrohet edhe në tabelën përkatëse, ky program përfshin tre produkte kryesore, të cilat lidhen ngushtësisht me funksionimin dhe mbështetjen e institucioneve të arsimit parashkollor. Produktet përfshijnë, së pari, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e edukatoreve që operojnë në kopshtet e qytetit dhe në njësitë administrative. Së dyti, përfshihen shpenzimet e tjera të përgjithshme, të cilat mbulojnë furnizimin e institucioneve me bazë materiale si kancelari dhe detërgjentë, për të garantuar ambiente mësimore të mirëmbajtura dhe funksionale. Po ashtu, përfshihen edhe pagesat për energjinë elektrike dhe ujin.

Të gjitha këto shpenzime dhe produkte janë rakorduar dhe verifikuar në bashkëpunim me Degën e Thesarit Përmes, duke siguruar përputhshmëri të plotë me kuadrin buxhetor dhe transparencën institucionale.

❖ **Funksioni “Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët”**

Ky funksion synon ofrimin e një mbështetjeje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për shtresat më të ndjeshme të shoqërisë, në veçanti për fëmijët dhe familjet në nevojë. Në këtë kuadër, sigurohet baza materiale dhe logjistike për funksionimin e strukturave të kujdesit social, si çerdhet, qendrat sociale dhe njësitë e tjera që ofrojnë shërbime për komunitetin. Mbështetja përfshin furnizimin me ushqime,



përkujdesjen nga personeli edukativ dhe ndihmës, si dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e fëmijëve në mjedise të sigurta dhe të stimuluar. Gjithashtu, në kuadër të këtij funksioni është përfshirë edhe implementimi i projekteve sociale me ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet, si p.sh. projekti RIWET. Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve synohet rritja e aksesit në shërbime sociale, përmirësimi i mbrojtjes së fëmijëve dhe promovimi i përfshirjes sociale në nivel vendor.

Realizimi i shpenzimeve të 4-mujorit të parë të vitit 2026, për këtë funksion, përfaqëson rreth 20 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të krahasuar me planin vjetor dhe 4-mujor rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit i 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	20,789	6,581	6,523	99	pjeserisht
Shpenzime kapitale	6,055	6,055	0	0	
Procedura pune të realizuara / Materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre, shpenzime transporti, udhëtimi brenda dhe jashtë vendit dhe të tjera operative, ne	13,708	5,840	1,745	30	pjeserisht
TOTALI	40,552	18,476	8,268	45	

Sikurse pasqyrohet edhe në tabelën përkatëse, ky program përfshin tre produkte kryesore. Ndër elementët themelorë të tij janë pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit të Bashkisë, si dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme që lidhen me funksionimin e institucioneve. Këto përfshijnë kostot për energjinë elektrike, furnizimin me ujë dhe shpenzime të tjera operacionale. Të gjitha produktet dhe zërat e shpenzimeve të këtij programi janë rakorduar dhe verifikuar në bashkëpunim me Degën e Thesarit Përmet, duke garantuar përputhshmëri të plotë me kuadrin buxhetor dhe transparencë financiare.

4- Programi AD135 "Argëtim, Zhvillim dhe Sporte"

Ky program synon nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën kulturore dhe sportive, përmes organizimit dhe mbështetjes së ngjarjeve të ndryshme në territorin e njesisë së vetëqeverisjes



vendore. Ai përfshin promovimin dhe mbrojtjen aktive të vlerave të trashëgimisë kulturore, si dhe inkurajon zhvillimin e aktiviteteve që forcojnë identitetin lokal dhe kohezionin social. Në kuadër të këtij programi është përfshirë edhe zbatimi i projektit URBACT. Gjithashtu, programi mbështet organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse dhe argëtuese, si dhe menaxhimin dhe funksionimin e institucioneve dhe infrastrukturës që lidhen me këto fusha, me synimin për të nxitur një jetë aktive, pjesëmarrëse dhe të shëndetshme për qytetarët e të gjitha moshave.

Realizimi i shpenzimeve të 4-mujorit të parë të vitit 2026, për këtë funksion, përfaqëson rreth 14 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit I 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	18,246	6,637	5,832	88	pjeserisht
Shpenzime kapitale	20,723	20,723	25	0.1	
Procedura pune të realizuara, në funksion të aktiviteteve të institucionit	10,092	6,592	1,135	17	pjeserisht
TOTALI	49,061	33,952	6,992	21	

Sikurse pasqyrohet edhe në tabelën përkatëse, ky program përfshin tre produkte kryesore. Ndër komponentët themelorë janë pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit të Bashkisë, si dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme. Në këtë kategori përfshihen edhe pagesat për ekipet e ndryshme që operojnë në qytet, mbështetur nëpërmjet projektit RELOAD, i cili synon forcimin e pjesëmarrjes rinore dhe zhvillimin e aktiviteteve komunitare.

Nga ana tjetër, shpenzimet kapitale lidhen me ndërhyrjet në infrastrukturë dhe përfaqësohen nga **Bashkefinancimi i Stadiumit në bashkepunim me FSHF**, një investim i rëndësishëm që synon përmirësimin e kushteve për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën aktive komunitare.



❖ **Funksioni: Shërbimet Rekreative dhe Sportet**

Ky funksion synon nxitjen e pjesëmarrjes aktive të komunitetit në jetën sociale dhe sportive, përmes organizimit të aktiviteteve me karakter sportiv, çlodhës dhe argëtues. Ai përfshin gjithashtu zhvillimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e institucioneve dhe objekteve të dedikuara për ushtrimin e këtyre aktiviteteve, duke përfshirë fusha sportive, palestra, qendra komunitare dhe ambiente të tjera publike që i shërbejnë aktiviteteve të kohës së lirë. Ky funksion përfaqëson një mjet të rëndësishëm për promovimin e një jete aktive, të shëndetshme dhe gjithëpërfshirëse për qytetarët e të gjitha moshave, si dhe kontribuon në rritjen e ndërveprimit social dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në nivel lokal.

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin e parë të vitit 2026 për këtë funksion paraqitet në nivelin 0 kundrejt planit të parashikuar. Ky mosrealizim lidhet me faktin se aktivitetet dhe procedurat e planifikuara nuk janë zhvilluar ende gjatë 4-mujorit të parë, ndërsa fondet e parashikuara pritet të realizohen në muajt në vijim, në përputhje me nevojat dhe ecurinë e zbatimit të aktiviteteve të institucionit.

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit I 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	0	0	0	0	
Shpenzime kapitale	11,595	11,595	0	0	
Procedura pune te realizuara, ne funksion te aktiviteteve te institucionit	6,530	3,393	0	0	
TOTALI	18,125	14,988	0	0	

Sikurse pasqyrohet edhe në tabelën përkatëse, ky funksion përfshin tre produkte kryesore, të lidhura me mbështetjen e aktiviteteve sportive dhe përmirësimin e infrastrukturës sportive në territorin e Bashkisë. Në kategorinë e shpenzimeve operative përfshihen shpenzime për lidhje energjie dhe blerje uniformash sportive. Në kategorinë e investimeve kapitale janë parashikuar bashkëfinancimi i stadiumit në bashkëpunim me FSHF-në ,rikonstruksioni i Pallatit të Sportit si



dhe shërbimet e supervizimit dhe kolaudimit për këtë investim . Të gjitha produktet dhe zërat përkatës të këtij funksioni janë rakorduar dhe verifikuar me Degën e Thesarit Përmet, duke garantuar përputhshmëri të plotë me zbatimin buxhetor dhe transparencën financiare.

❖ Funksioni: Argëtim dhe Zhvillim

Ky funksion përfshin organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve kulturore dhe artistike brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes qytetare dhe ruajtjen e identitetit lokal. Në thelb të tij qëndron promovimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore, përfshirë asetet me vlera historike, ndërtimore dhe natyrore, që përbëjnë pasurinë shpirtërore dhe historike të komunitetit. Përmes këtij funksioni synohet jo vetëm gjallërimi i jetës kulturore në nivel vendor, por edhe ndërgjegjësimi i brezave të rinj për rëndësinë e ruajtjes së vlerave kombëtare dhe lokale, si dhe zhvillimi i potencialit turistik dhe kulturor të zonës.

.Realizimi i shpenzimeve të 4-mujorit të parë të vitit 2026, për këtë funksion, përfaqëson rreth 23 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të, krahasuar me planin vjetor rezultojnë si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit I 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	18,246	6,637	5,832	88	
Shpenzime kapitale	9,128	9,128	25	0.2	
Procedura pune të realizuara, në funksion të aktiviteteve të institucionit	3562	3,199	1,135	35	pjesërisht
TOTALI	30,936	18,964	6,992	37	

Sikurse paraqitet edhe në tabelën përkatëse, ky program përfshin tre produkte kryesore. Produktet bazë përbëhen nga pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit të Bashkisë, shpenzimet e tjera të përgjithshme, si dhe pagesat e kryera për zërat e investimeve kapitale. Të gjitha shpenzimet dhe



produktet që lidhen me këtë program janë rakorduar dhe verifikuar me Degën e Thesarit Përmet, duke siguruar një përputhje të plotë me planifikimin buxhetor dhe zbatimin financiar përkatës.

5- Programi AE135 "Siguria e qytetarit dhe mbrojtja e mjedisit"

Ky program ka në fokus garantimin e sigurisë së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel vendor, përmes një qasjeje të integruar që kombinon ndërhyrjet emergjente, parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve.

Një komponent i rëndësishëm i programit është **garantimi i funksionimit të shërbimit zjarrfikës**, përfshirë administrimin dhe mirëmbajtjen e strukturave përkatëse. Aktivitetet përfshijnë reagimin në kohë ndaj situatave emergjente, **parandalimin dhe luftimin e zjarreve**, si dhe **menaxhimin e situatave të rrezikshme** që rrjedhin nga fatkeqësi natyrore, aksidente rrugore apo ngjarje të tjera me ndikim në sigurinë publike.

Gjithashtu, programi synon **rritjen e nivelit të sigurisë së qytetarëve** në qytet dhe në njësitë administrative, përmes patrullimeve të vazhdueshme, kontrollit të territorit dhe mbrojtjes së pronës publike nga dëmtimi, degradimi apo uzurpimi.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij programi është **ruajtja e mjedisit dhe ndërgjegjësimi i komunitetit**, si pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësim të cilësisë së jetës në territorin e bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve të 4-mujorit të parë të vitit 2026, për këtë funksion, përfaqëson rreth 23 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të, krahasuar me planin vjetor rezultoi si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit I 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	35,745	12,877	10,750	83	pjeserisht
Shpenzime kapitale	6,727	0	0	0	
Procedura pune të realizuara / Materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre, shpenzime transporti,	5,017	3,322	322	10	pjeserisht
TOTALI	47,489	16,199	11,072	68	



Sikurse paraqitet edhe në tabelën përkatëse, ky program përfshin tre produkte kryesore. Ato përbëhen kryesisht nga pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit të Shërbimit Zjarrfikës dhe Policisë Bashkiake, si dhe nga shpenzimet e tjera të përgjithshme për funksionimin e strukturave përkatëse. Në zërin e shpenzimeve kapitale janë përfshirë edhe investimet për pajisjen e institucionit me mjete të nevojshme për përmirësimin e kapaciteteve të punës. Të gjitha produktet dhe shpenzimet e këtij programi janë rakorduar dhe verifikuar me Degën e Thesarit Përmet, duke garantuar transparencë dhe përputhshmëri me planifikimin buxhetor.

6-Programi AF135 "Transfera të individëve, institucione, organizata"

Ky program synon të garantojë mbështetje financiare në raste të situatave të papritura, me qëllim minimizimin e rreziqeve sociale dhe ekonomike që prekin individët, familjet apo institucionet në nivel vendor.

Përmes këtij programi parashikohen **transfera të drejtpërdrejta buxhetore** që shërbejnë si mekanizëm mbështetës për përballimin e situatave emergjente, sidomos për familjet e dëmtuara nga fatkeqësi natyrore, zjarre apo ngjarje të tjera të paparashikuara. Po ashtu, programi mbulon nevoja të veçanta që nuk janë parashikuar paraprakisht në buxhetin fillestar, duke vepruar si një fond fleksibël për raste të jashtëzakonshme.

Qëllimi kryesor është zbutja e pasojave sociale dhe ekonomike për kategoritë më të rrezikuara dhe ndihma në ruajtjen e stabilitetit social në komunitet përmes ndërhyrjeve të shpejta dhe të synuara.

Realizimi i shpenzimeve të 4-mujorit të parë të vitit 2026, për këtë funksion, përfaqëson rreth 11 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2026 në mijë lekë	Buxheti 4 mujor	Realizimi faktik i 4- mujorit I 2026		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	0	0	0	0	
Shpenzime kapitale	0	0	0	0	



Procedura pune te realizuara /, ne funksion te aktiviteteve te institucionit	4,991	3,895	555	14	pjeserisht
TOTALI	4,991	3,895	555	14	

Në zërin e shpenzimeve të tjera të përgjithshme janë përfshirë pagesat për transferta të drejtpërdrejta ndaj individëve, të cilat kanë shërbyer si mbështetje në raste emergjente apo nevoja të papritura sociale. Këto transferta janë realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në funksion të zbutjes së pasojave nga fatkeqësi të ndryshme. Të gjitha shpenzimet dhe produktet që lidhen me këtë program janë **rakorduar dhe verifikuar me Degën e Thesarit Përmet**, duke garantuar përputhje të plotë me planifikimin dhe disiplinën buxhetore.

Nr	Struktura	Plani vjetor	Fakti
1	Gjendja civile 1170	5,061,600	1,914,456
2	Paaftesia 10430	22,118,000	21,361,568
3	Ndihma ekonomike 10430	1,702,000	1,187,072
4	Projekti Social Perqafimi I Shpreses 10430	2,598,175	288,006
5	11.9120.01 (Bursa per nxenesit)	329,400	-
6	17.10910.01 Mbrojtja Civile (Emergjenca Civile) (604)	5,095,270	-
7	17.10910.01 Mbrojtja Civile (Emergjenca Civile) 231	5,095,270	-
TOTAL MINISTRI LINJE		41,999,715	24,751,102

Gjatë katërmujorit të parë të vitit, nga fondet e planifikuara nga ministritë e linjës në vlerën totale prej **41,999,715 lekësh**, janë realizuar **24,751,102 lekë**, që përbëjnë rreth **59%**.

Në materialin e mësipërm janë paraqitur edhe projektet me financim të huaj me skemë të plotë thesari dhe me skemë të pjesshme thesari, si dhe vlerat e bashkëfinancimit të Bashkisë. Gjithashtu, diferenca ndërmjet raportit tonë dhe raportimit në SMBV lidhet, përveç projekteve të ministrive të linjës, edhe me projektin SEPAC me vlerë të planifikuar 34,409,000 lekë dhe fakt 0 lekë. Ky projekt, duke qenë me skemë të pjesshme thesari, nuk mund të regjistrohet në sistemin SMBV për shkak të kufizimeve të sistemit, ndërkohë që në raportin e Bashkisë është përfshirë dhe pasqyruar sipas evidencave zyrtare të Thesarit. Për rrjedhojë, evidencat e raportit tonë janë në përputhje me evidencat e Thesarit, ndërsa diferenca konstatohet vetëm në raportim me SMBV.



Më poshtë po trajtojmë çdo projekt më vete duke ju detajuar dhe fondet me skemë të pjeshme thesari .

Në buxhetin e projekteve janë parashikuar shpenzimet e mëposhtme për 4 mujorin e parë të vitit 2026 :

I. Projekti SEPAC (Mjedise të Qëndrueshme në Zonat e Mbrojtura për përdorim më të mirë nga qytetarët) financuar nga IADSA.

Objekti i përgjithshëm është mbështetja për rritjen e turizmit të qëndrueshëm të Bashkive të Përmetit dhe Këlcyrë, nëpërmjet promovimit dhe përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve turistike.

Objektivat specifike janë :

- Të krijojë mundësi punësimi dhe të përmirësojë shërbimet ekzistuese social-kulturore në Bashkitë Përmet dhe Këlcyrë. Ruajtja e trashëgimisë natyrore.
- Të promovojë zgjidhje inovative për zonat e mbrojtura dhe sistemet eko të brishta, të inkurajojë një mjedis të pastër, specie të mbrojtura të kafshëve dhe perimeve dhe akses dhe përdorim më të mirë të tyre nga qytetarët vendas.

Ndërhyrjet kryesore të parashikuar në projekt janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës në fshatin Bënjë.
- Përgatitja dhe zbatimi i një plani gjithëpërfshirës të menaxhimit për Ujërat Termale të Bënjës.
- Festivalit i Ditës së Verës në Përmeti si një aktivitet promovues i përvitshëm.
- Ndërtimi i një ballkoni Panoramik.

KAPITULL 2 SKEME E PJESSHME THESARI					
SEPAC	Vjetori	4-mujori	Fakt	% 4-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
230+231	13755	13755	0	0%	0%
604	20634	20634	0	0%	0%
602	20	10	0	0%	0%

KAPITULL 1					
SEPAC	Vjetori	4-mujori	Fakt	% 4-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
231	4323	4323	0	0%	0%



Aktivitetet e parashikuara gjatë kësaj periudhe nuk janë realizuar për arsye se nuk ka patur disbursim të transeve nga donatori.

2. Projekti RIWET (Qeverisja publiko-private e lumenjve dhe restaurimi dhe ruajtja e ligatinave si infrastrukturë blu&jeshile)

Bashkia Përmet është një ndër bashkitë e para në Shqipëri që përfiton nga ky program. Në këtë projekt Bashkia do të fokusohet te Lugina e Vjosës. Aktivitetet kryesore janë:

- Organizimi i takimeve periodike me grupet e interesit
- Shkëmbim eksperience nga praktikat e mira të partnerëve
- Pjesëmarrja në të gjitha Webinarët dhe Takimet e Komitetit Drejtues.
- Organizimi i një Workshopi për Shkëmbimin e Përvojave (EEW) në Përmet për të shkëmbyer praktikat e mira mbi bashkëpunimin publik-privat në lidhje me Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Lumit Vjosa dhe angazhimin e komunitetit për mbrojtjen e biodiversitetit dhe natyrës.
- Identifikimi i praktikave të mira që duhen ndarë me partnerët

KAPITULL 1					
RIWET	Vjetori	4-mujori	Fakt	% 4-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
600	2809	1405	1404	100%	50%
601	471	235	172	73%	50%
602	1560	1180	951	81%	76%

3. Projekti ARCHETHICS Trashëgimia disonante evropiane si laborator i demokracisë.

Të gjithë partnerët do të angazhohen për të hartuar një plan veprimi të integruar për menaxhimin e trashëgimisë disonante.

Plani do të hartohet nga stafi i projektit me mbështetjen e ekspertëve dhe grupit lokal të veprimit URBACT (ULG). Ky grup ka në përbërje të tij aktorë të ndryshëm të lidhur me tematikën e projektit dhe roli i tyre është shumë i rëndësishëm pasi pjesëmarrja dhe angazhimi i tyre do të ndikojë në hartimin e një plani gjithëpërfshirës dhe efektiv pasi konsideron pikëpamjet e gjithë grupeve të interesit. Në rastin e Bashkisë Përmet, grupet e interesit janë përfaqësues të pushtetit lokal, të institucioneve arsimore, universitetit, të rinj, qytetarë, historianë etj.

Trashëgimia disonante e Përmetit përbën një potencial për zhvillimin e turizmit.

“Trashëgimia disonante” si një burim për turizmin paraqet sfida të reja për institucionet publike dhe operatorët turistikë. Sfida kryesore lidhet me rritjen e “trashëgimisë disonante” si një shtytës i turizmit të qëndrueshëm dhe marketingut territorial. Është e nevojshme të vendoset “trashëgimia disonante” në qendër si një pasuri kulturore parësore për të përfshirë edhe forma të tjera të turizmit në mënyrë të integruar (p.sh. turizmi kulturor, turizmi historik, turizmi i jashtëm dhe i ngadaltë, turizmi i kuzhinës, turizmi mjedisor).



KAPITULL 2 SKEME E PLOTE THESARI					
ARCHETHICS	Vjetori	4-mujori	Fakt	% 4-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
600	626	626	624	100%	100%
601	106	106	104	97%	97%
602	250	250	243	99%	99%

4. PROJEKTI EURBAN DECO

“Eksplorimi i peisazheve urbane të BE-së për një dekonstrukcion të narrativave koloniale”

Projekti shqyrton trashëgiminë koloniale brenda mjediseve urbane të Evropës. Duke eksploruar simbolet, tregimet dhe toponiminin, ai synon të ekspozojë ndikimin e qëndrueshëm të ideologjive koloniale në qytetet e BE-së. Projekti financohet nga programi i Bashkimit Evropian CERV.

Objektivat:

1. Sensibilizimi mbi marrëdhëniet midis peizazheve urbane, kujtesën historike të së kaluarës koloniale dhe integrimin multikulturor.
2. Ekspozimi i trashëgiminë koloniale brenda mjediseve të qyteteve të BE-së dhe fillimi i një debat kolektiv rreth ndikimit të saj.
3. Nxitja e narrativa të reja dhe përkujtime kulturore të përbashkët me përfshirjen aktive të grupeve të pakicave dhe komuniteteve të emigrantëve.
4. Ngritja e një nisme ndërkombëtare për të tërhequr vëmendje më të gjerë mbi këtë temë nga autoritetet publike dhe palët e interesuara.

Rezultatet e pritshme:

- Një koleksion hartash urbane të rishikuara për 7 qytetet e përfshira në projekt, duke përshkruar referencat kryesore të lidhura me trashëgiminë koloniale dhe duke i riemëruar ato nën perspektivën e popujve të kolonizuar.
- 7 evente ndërkombëtare (secila e fokusuar në një nën-temë specifike të historisë koloniale të BE-së) me një pjesëmarrje të madhe dhe me përfshirjen aktive të grupeve të synuara
- Një nismë ndërkombëtare me qëllim tërheqjen e vëmendjes së politikëbërësve ndaj temës së trashëgimisë koloniale në qytetet e BE-së dhe kërkimi i veprimit kolektiv për ta ri-diskutuar atë.

KAPITULL 1: SKEME E PLOTE THESARI					
EURBAN DECO	Vjetori	4-mujori	Fakt	% 4-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
602	400	400	400	100%	100%

5. Projekti “Përqaftimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë”



Ky projekt i referohet tipologjisë së shërbimit : Shërbim gjysmë ditor (mbështetje psikologjike, kujdes shëndetësor, aktivitete të kohës së lirë, përfshirje në jetën social kulturore dhe 1 vakt ushqim) për kategoritë të moshuar të vetmuar, persona me PAK, pjesë e Komunitetit Egjyptian dhe individë në situatë të vështirë ekonomike.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti: Përmirësimi i qasjes në shërbime sociale përmes rritjes së numrit dhe llojeve të

shërbimeve që ofrohen në territorin e bashkisë. (Qëllimi 2 në planin social). Për të kontribuar në arritjen e këtij qëllimi ky projekt ka dy objektiva specifike:

Objektivi 1: Të ngrihet dhe të vihet në funksion qendra ditore e të moshuarve duke ofruar shërbime për të moshuarit dhe grupet në nevojë. (Shërbimet do të ofrohen për të moshuarit e vetmuar, personat me aftësi të kufizuara, personat në situatë vulnerabiliteti të shumëfishtë.)
Objektivi 2.3 në Planin Social

Objektivi 2: Të rrisë përfshirjen sociale të moshës së tretë dhe grupeve në nevojë në qytetin e Përmetit nëpërmjet realizimit të aktiviteteve social-kulturore.

Kohëzgjatja e zbatimit të projektit është Janar 2025- Dhjetor 2027

Rezultatet e lidhura me objektivin 1:

Funksionimi i qendrës ditore, ofrimi i shërbimeve sociale dhe 1 vakt ushqimor për këtë kategori.

Rezultati 1.1: 30 persona përfshirë të moshuar të vetmuar dhe persona të tjerë në situatë vulnerabiliteti marrin shërbim një vakt ushqimor.

Rezultati 1.2: 30 persona marrin shërbim social (mbështetje psikologjike, kujdes shoqëror, aktivitete të kohës së lirë, përfshirje në komunitet).

Rezultati 1.3: Të paktën 50 persona informohen për shërbimet sociale lehtësuese që ofrohen në Bashkinë Përmet.

Rezultati 1.4: Të paktën 50 persona marrin pjesë në aktivitetet artistike-kulturore të organizuara.

Rezultati 1.5: Të paktën 20 të rinj i bashkohen nismës "1 ditë vullnetar".

Rezultati 1.6: Të paktën 20 të moshuar kanë një ambient të dedikuar për të kaluar kohën e lirë.

Rezultatet e lidhura me objektivin 2:

Realizim i aktiviteteve që nxisin pjesmarrjen dhe përfshirjen e moshës së tretë në qytetin e Përmetit.

Rezultati 2.1 : Realizimi i aktivitetit "Krijojmë kujtime".

Rezultati 2.2 : Realizimi i aktivitetit "Sporti dhe shëndeti" 6 Prill Dita Botërore e Sportit.

Rezultati 2.3 : Realizimi i eventit " Mirënjohje " 1 Tetori.

Rezultati 2.4 : Realizimi i aktivitetit 1 film në Kinema.

KAPITULL 1						
		Vjetori	4-mujori	Fakt	% 4-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
Fondi Social	606	2598175	866058	288006	33%	33%
Financim Bashkia	602	1677490	559163	73497	13%	33%



Ky projekt është në vitin e dytë të zbatimit. Financimi për vitin 2026 është 60% nga Fondi Social dhe 40% nga Bashkia Përmet. Të gjitha aktivitetet e projektit kanë vijuar normalisht që prej fillimit të vitit përveç shërbimi i ofrimit të një vakti ushqimor procedura për të cilin përfundoi në muajin Mars nga Operatori I Blerjeve të Përqëndruara duke lidhur kontratat me operatorët fitues në datën 1.04.2026 dhe vijuar shërbimin normalisht prej datës 2 Prill 2026.

BASHKIA PËRMET

Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiar normale dhe rastet e vështirësive financiare

Muaji Janar- Prill 2026

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzim e vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzim e vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	2,648,974		1 %
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore	302,088		
4864200	Det.Prap. Sherbime			
4864201	D.P.EneriElektirke	2,346,886		
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	1,604,316		



4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronetime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	4,253,290	426,705,665	1%

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësitë e vetëqeverisjes vendore				
Situata Normale e gjendjes fiannciare	Probleme financiare	Vështirësi financiare	Vështirësi serioze financiare	Paafësi paguese
	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130%
Situat Normale e gjendjes fiannciare	0	0	0	0

Detyrime pushteti qendror	Llogaria ekonomike	Vlera ne leke
Ministri linje 17	4864400	2160000
FSHZH		
Fonde nga Rindertimi		



BASHKIA PERMET

Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

në lekë

Nr	EMERTIMI	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv) 30 PRILL 2026	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan) 2026
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	27,806,087	90,435,000
1	Taksat e veta vendore	8,412,684	26,592,000
a.	Taksa mbi pasurinë	6,431,018	17,969,000
b.	Biznesi i vogel	8,333	0
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	797,206	7,000,000
d.	Taksa të tjera vendore	1,176,127	1,623,000
2	Të ardhura jotatimore	16,649,927	52,943,000
a.	Tarifat e shërbimeve publike	16,566,788	52,943,000
b.	Tarifa administrative	68,254	0
c.	Të tjera jo tatimore	14,885	0
3	Taksa të ndara	2,743,476	10,900,000
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	0	200,000
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	2,338,404	6,200,000
c.	Renta minerare		
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	405,072	4,500,000
e.	Të tjera		
II	Shpenzime te Buxhetit Vendor	134,908,611	598,728,507
1	Shpenzime Korrente	119,126,209	455,965,333
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	86,080,709	277,003,040
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	14,274,818	46,276,172
d.	Shpenzime Operative	17,384,257	81,085,561
e.	Të tjera korrente	1,386,425	51,600,560
2	Shpenzime Kapitale	15,782,402	142,763,174
3	Burimet e Financimit	134,908,611	598,728,507

a.	Të ardhurat e veta vendore	17,442,443	99,127,940
b.	Transferta e pakushtezuar	79,664,742	269,227,681
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale	36,830,074	185,804,170
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit)		
f.	Financimi i huaj	971,352	44,568,716
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

Kryetar

Alma Hoxha






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2026

PËR

MIRATIMIN E FAZËS SË PARË TË BUXHETIT AFATMESËM 2027-2029

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për manaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetqeverisjes vendore, Udhëzimit nr.7 datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029", VKB nr.01 datë 23.01.2026 "Për miratimin e të ardhurave afatmesme për Buxhetin afatmesëm 2027-2029", VKB nr.20 datë 24.03.2026 "Për miratimin e tavaneve të Buxhetit afatmesëm 2027-2029" Këshilli Bashkiak, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentin e fazës së parë për Buxhetin Afatmesëm për vitet 2027-2029, për Bashkinë Përmet.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet-Financës, Burimeve njerëzore dhe logjistikës dhe administrata e bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA



SHTOJCA 2

Struktura e Dokumentit së Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor, 2027-2029





BASHKIA PERMET



PROJEKT DOKUMENTI

**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
2027 - 2029**

MAJ 2026

PËRMBAJTJA



1. HYRJE	5
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR	5
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	7
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË (1-2 FAQE)	5
2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE	5
2.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË PERMET	5
3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË / KËSHILLIT TË QARKUT (1-2 FAQE)	9
3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË	9
3.2 SHIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJA E PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRFITUESIT	9
4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË/QARKUT [EMRI] 2027-2029	10
4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË/PERMET NË VITET 2027-2029	11
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë/PERMET për vitet 2027-2029	11
4.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë/PERMET për periudhën 2027-2029	17
4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR	28
5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE	1
5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	2
5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	1
5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit	33
5.1.4 Informacione Bazë mbi Programin	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
6. BUXHETI VJETOR	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
6.1. DOKUMENTACIONI BAZË	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
6.2. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

Lista e Tabelave

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë/PERMET	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit.....	11
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike	18
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III i COFOG)	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	1
Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	2
Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	1
Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit.....	33
Tabela 9. Informacione bazë mbi Programin.....	<i>Error! Bookmark not defined.</i>

Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MF	– Ministria e Financave
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto
SMBV	– Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor





1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .



Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë përfshijnë njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin në kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësitë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësitë vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjatë' i referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.



Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.



planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2027-2029 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanëve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandiime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së



2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë

2.1 Situata e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

(Burimi i Informacionit: Plani i Përgjithshëm Vendor / Plani i Zhvillimit Strategjik PPV/PZHS)

2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë (Burimi i Informacionit: PPV / PZHS)

1.1 Situata e njesisë së vetëqeverisjes vendore

Bashkia Permet shtrihet në Juglindje të Shqipërisë në një territor prej 601.95 km², i cili kufizohet në veri me Bashkinë e Berat, në perëndim me Bashkinë Tepelene, në lindje me Bashkinë Erseke, në jug me Bashkinë Gjirokaster. Ajo ka nën administrimin e saj një qytet dhe 50 fshatra. Kjo ndarje administrative – territoriale përcaktoi si qendër të bashkisë së re qytetin e Permet, Qyteti u krijua si një qendër administrative, në shekullin e XV dhe XVI, cituar nga të dhëna historike turke, si një lokalitet i pasur me tregje, dyqane magazina dhe bujtina, kështu kjo zonë ishte një qendër e lulëzuar komerciale. Të dhëna historike otomane e viteve 1431-1432 referojnë se qyteti kishte 42 shtëpi ndërkohë në shekullin XVI numëronte 136 shtëpi. Në vitin 1931 Permeti kishte rreth 3000 banorë dhe 104 fshatra si zona të ndara. Gjatë Luftës së Dytë Botërore është djegur e përmbatur katër herë duke e shndërruar kështu disa herë. Sot qyteti i Permetit dhe njesite administrative janë shëndëruar në vend turistik për shumë turistë të huaj e vendës që vizitojnë qytetin e njesite në çdo stinë të vitit. Sot në qytet e NJA është e përhapur shumë kulinaria si ajo tradicionale dhe ajo moderne. Në qytet ka pika të prodhimit të glikove recelave të ndryshme, prodhimin verë e rakie.





Kultura

Në qytet vërehet një tolerancë fetare. Përmeti është i njohur në mbarë Shqipërinë për mikpritjen dhe gatimet shkëlqyera. Ia vlen të shihni edhe kishën e shekullit të XII të Shën Mërisë në Kosinë dhe atë të shekullit XVII të Leusës.

Përndryshe kultura e qytetit dallohet me një traditë të gjatë letrare dhe muzikore. Përpos Naimit vargjet e të cilit edhe në ditë tona janë të kërkuara nga Përmeti vijë edhe shkrimtarët e njohur si p.sh.: Bardhyl Londo apo Sejfulla Maleshova. Muzikantë të dalluar të nivelit kombëtarë si Mentor Xhemali e Laver Bariu janë përkujdesur që muzika përmetare të dallohet me karakteristikat e saja të një tradite të gjatë kulturore.

Përmeti është vendlindja e tre vëllezërve Frashëri dhe disa personaliteteve të njohura të kulturës mbarë shqiptare siç është skulptori Odhise Paskali, shkrimtari Nonda Bulka, aktorës *artiste e popullit* Tefta Tashko Koço dhe këngëtarës së muzikës së lehtë Anjeza Shahini e deri te gazet e Permetit, jehona e grupit të tyre i ka kaluar kufijt kombetar.

Në qytetin e trëndafilave siç e quajnë me përkëdhelje banorë e tij, nxënësi ndjekin mësimet në dy shkollat fillore, në shkollën "Nonda Bulka" dhe atë "Meleq Gosnoshti" dhe në gjimnazin "Sami Frashëri" dhe ka shkolla 9- vjecare e kopshte në cdo Nj A .

Ekonomia

Deget e ekonomisë në rrethin e Permetit janë: bujqësia, blegësia, bletaria, frutikultura, turizmi dhe transporti. Në bujqësi, rendesi zënë bimët e arave, midis të cilave dallohet gruri, i cili gjëhet kushte të favorshme zhvillimit në të gjitha zonat. Frutikultura me pemë të shumëllojshme dhe vreshtaria, të cilat janë baza kryesore në industrinë perpunuese që operon në këtë bashki. Përparsi i jepet turizmit. Vitet e fundit ky qytet është një ndër qytetet më të vizituara si nga vizitorët e vendit ashtu dhe turistët e huaj .

Aktualisht ky bashki ka një popullsi prej 18 647 banorë. Përqëndrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Permetit me 51 % të popullsisë (9 527 banorë), ndërsa për sa i përket njësive administrative, njësia me popullsinë më të madhe është ajo e Rrethinave me 9 120 banorë. Parë nga këndvështrimi i raportit gjinor, popullsia e Bashkisë Permet ruan një diferencë të lehtë për sa i përket ndarjes gjinore të popullsisë, në meshkuj e femra duke shprehur një situatë gjinore pothuaj të balancuar.

Bizneset e vogla, të cilat janë edhe katalizatorë të zhvillimit. Krijimi, zhvillimi dhe përmirësimi i këtyre bizneseve përbën një potencial të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Bizneset kryesore që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik janë kryesisht të orientuara në industrinë perpunuese, në përpunimin e produkteve bujqësore (Fruta ,Agrume ,etj), të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Gjithashtu edhe prania e bizneseve të artizanatit të cilët kanë një traditë të vjetër në qytetin e Permetit, vazhdon akoma sot duke luajtur rol të veçantë në ekonominë vendore. Industria perpunuese përbën një nga potencialet më të mëdha të zhvillimit në Permet. Prania e zonës industriale në Permet , në të cilën janë përqëndruar biznese perpunuese është një tjetër element me rëndësi në zhvillimin ekonomik, duke ofruar punësim dhe të ardhura për popullsinë.



Një tjetër avantazh konkurrenës i Bashkisë Permet si rrjedhojë e pozicionit të saj gjeografik është edhe zhvillimi i turizmit të shumëllojshëm dhe gjithë-vjetor. Kjo nënkupton zhvillimin e turizmit kulturor dhe historik, zhvillimin e turizmit malor.

Në zonën e Permetit ekziston një gamë e gjerë bukurish natyrore, që nga malet deri brigjet e lumit me te bukur e me te rrembyer ne Ballkan Lumit Vjosa. deri në muret shkëmbore të Gurit te Qytetit i cili qëndron madhështor ne qytet .

Duke qënë qënder urbane në rajonin Jug –Lindor Permeti gjithashtu krijon mundësi të shumta në zhvillimi e sektorit të shërbimeve dhe të tregtisë. Në këtë mënyrë, Bashkia Permet, shihet si porta e Jugut duke konsideruar këtu edhe rolin influencues që ka në rajon me qytetet ndërkutare me Greqinë .

1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë

Burimi i informacionit: PPV/PZHS

Bashkia Permet mbështet skenarin policentrik të zhvillimit të territorit të saj. Ky skenar paraqitet si koncept në dy nivele, si në nivelin Bashkiak, ku për qëllime të kohezionit territorial kërkohen disa qëndërsi të reja në ofrimin e shërbimeve bazë (shkollë, qënder shëndetësore, postë), ashtu dhe në nivel qyteti, ku shërbimet dhe aktivitetet duhet të shpërndahen më shumë në territor .Zona urbane Permet ka nevojë të krijojë qëndërsi të reja urbane rreth qendrës historike. Këto qëndërsi të reja urbane konsolidojnë strukturën ekzistuese, pa ndikuar në tipologjitë historike të ndërtimit. Ndërkohë zonat rurale kanë nevojë për të përmirësuar qendrat ekzistuese. Kjo qasje do të ruajë tokën bujqësore dhe burimet natyrore. Pra nga njëra anë skenari i policentrizmit promovon shpërndarjen në territor të centraliteteve (sipas një hierarchie të caktuar) dhe një vëmendje më të madhe në përmirësimin e cilësisë urbane edhe në zonat rurale, ndërkohe që nga ana tjetër promovon kompaktësimin dhe konsolidimin e tyre për të mos u shpërhapur në territor. Ky skenar promovon një zhvillim shumë- dimensional të ekonomisë dhe arritjen e qëllimit për zhvillimin rajonal duke promovuar edhe kohezionin territorial. Gjithashtu, krijohet një hierarki qendrash nga primare urbane (qyteti Permet) deri tek qëndra lokale të cilat ofrojnë shërbime bazë për komunitetin. Gjithashtu skenari policentrik promovon mbrojtjen e burimeve natyrore e ujore duke garantuar mundësinë për zhvillimin e turizmit gjithëvjetor sipas parashikimeve të PPK dhe PINS.



1.1 Informacion financiar Kryesor

Burimi i informacionit: Nxjerrë nga Instrumenti i Planifikimit Financiar

Në vijim të ndarjes së re administrative territoriale (shtimit të 4 njësi administrative) dhe ligjit të ri për vetë-qeverisjen vendore, bashkia Permet përballlet me sfidën e menaxhimit burimeve financiare të kufizuara përkundrejt nevojave gjithmonë në rritje për shërbime dhe investime kapitale. Në këtë kontekst, planifikimi strategjik i investimeve kapitale në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike në territoret në administrim rezulton i domosdoshëm dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik vendor. Ndaj, vlerësohet thelbësor fuqizimi dhe përmirësimi i performances financiare në drejtim të rritjes së të ardhurave dhe uljes së shpenzimeve.

Në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të veta të bashkisë, përdorimi i instrumenteve financiar fondet shtetërore nga (FZHR etj) të orientuara kryesisht në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës, fondet nga donatorët e huaj (Bashkimi European, Banka Botërore, USAID etj) për çështje që lidhen me trajtimin i mbetjeve dhe ujërave, asistencë teknike dhe ndërtim kapacitetesh apo edhe format e partneritetit publik-privat paraqesin një mundësi reale për realizimin e investimeve kapitale.

Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme rritja e kapaciteteve të bashkisë në drejtim të hartimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve nëpërmjet këtyre formave të financimit. Një burim tjetër të ardhurash i cili kërkon ngritje të kapaciteteve lokale është i lidhur me programet e huaja të tilla si programi për Bashkëpunimin Ndërkufitar IPA me Greqinë. Në këto programe është e rëndësishme që të krijohen strukturat e duhura të bashkëpunimit në mënyrë që të përfitohen projekte dhe të ardhura shtesë për realizimin e tyre.



3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë

3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

(Burimi i Informacionit: PPV / PZHS)

3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsyet dhe Përfituesit

- Integrimi i turizmit me sektore të tjerë të ekonomisë.
- Përmirësimi i aksesit në zonat rurale me qëllim zbutjen e pabarazive dhe ofrimin e shërbimeve administrative në të gjithë territorin e Bashkisë.
- Zhvillimi ekonomik me theks në mjedis mjedisit në mënyrë që të garantohet mbrojtja e ekosistemeve dhe vlerave të shumta natyrore të permetit. Boshtet kryesore të zhvillimit ekonomik do të jenë zhvillimi rural (bujqësia dhe blegtoaria), turizmi, industria e lehtë/përpunimi, shërbimet, dhe ekonomia e të ardhmes e bazuar në sistemet e teknologjisë së informacionit,
- Kujdes i veçantë duhet të tregohet për integrimin e brezave të rinj në ekonomi, dhe krijimin e mundësive për iniciativat në kuadër të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

(Burimi i Informacionit: PPV / PZHS; Fishat e Projekteve, të tjera)

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË PERMET 2027-2029



Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Permet gjatë periudhës 2027-2029, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike, nëse janë planifikuar të tillë. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2027-2029, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2027-2029. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia.

- Projektet e identifikuara gjatë procesit të Plant Strategjik Nder-Lokal përmban disa projekte, disa prej të cilave janë përzgjedhur si projekte prioritare, që do të implementohen brenda një afati prej 3 vjetësh.

Projektet prioritare përfshijnë investime në fusha të ndryshme si:

Ujitja dhe Kullimi:

- Kanali ujitës Rapckë
- Sistem vadites per fshatin Kutal dhe Ish SMT Mbikqyrje Kolaudim Oponence VNM

Infrastruktura Rrugore

- Ndërtimi i rrugës hyrëse fshati Qilarisht
- Rikonstruksion i rrugës Draçovë - Kanikol
- Ndërtimi i rrugës Buhal - Përmet
- Ndërtimi i rrugës hyrëse Pacomit
- Sistemim – asfaltim i rrugës në lagjen "Nonda Bulka" Përmet
- Sistemim – asfaltim i rrugëve në "Lagjen e Re" Përmet
- Sistemim – asfaltim i rrugëve në lagjen "SEDE" Përmet

Sherbime Publike:

- Rehabilitim i KUZ Përmet
- Ndërtim i urës së varur midis parkut "Aristidh Kola "dhe" Kupola"
- Ndërtim i urëslihdhëse midis "lagjes Bajame " dhe "Lagjes së Re"

Mbetjet:

- Rehabilitim dhe pyllëzim i vend depozitimit të mbetjeve

Ujësjiellësa:

- Ujësjiellësi rajonal faza II

Projektet e sipërpërmendura janë prioritare dhe një pjesë e të cilave kanë si burim financimi të ardhurat e bashkisë pjesa tjetër mbeten projekte potencialisht strategjike, të cilat mund të zbatohen në momentin e sigurimit të burimeve financiare.

4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë/Permet në vitet 2027-2029

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë/Permet për vitet 2027-2029

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit

RAPORTI PBA2: PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE

	Burimet Buxhetore	2024 Fakti	2025 Fakti	2026 Plani Fillestar	2026 Plani i Rishikuar	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	44,171	64,619	79,735	79,735	88,180	88,425	88,425
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	10,985	14,798	18,169	18,169	20,580	20,590	20,590
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	7,418	10,720	12,795	12,795	15,000	15,000	15,000
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	1,652	2,611	3,623	3,623	2,200	2,200	2,200
1.1.3	Taksa mbi truallin	1,501	1,346	1,551	1,551	1,900	1,900	1,900
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	415	122	200	200	1,480	1,490	1,490
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	1,331	8,112	7,000	7,000	10,780	10,790	10,790
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	1,331	8,112	7,000	7,000	10,780	10,790	10,790
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	744	771	1,623	1,623	900	900	
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	154	44	0	0	0	0	



1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	289	307	1,000	1,000	500	500	500
1.3.3	Taksa e tabelës	301	419	623	623	400	400	400
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0	0	0	0	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
1.4	TARIFA VENDORE	26,114	34,894	45,122	45,122	50,220	50,445	50,445
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	14,332	15,821	23,871	23,871	20,000	20,000	20,000
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	1,078	1,513	907	907	1,200	1,200	1,200
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	4,037	4,358	5,790	5,790	9,000	9,000	9,000
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	1,963	2,354	2,950	2,950	6,000	6,000	6,000
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	40	271	0	0	0	0	0
	Burimet Buxhetore	2024 Fakti	2025 Fakti	2026 Plani Filjestar	2026 Plani i Rishikuar	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	1,830	1,268	2,693	2,693	2,345	2,350	2,350
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	0	0	0	0	0	0	0
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	19	177	0	0	0	0	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	233	266	300	300	800	1,000	1,000
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
1.4.11	Tarifa e parkimit	60	80	150	150	1,000	1,000	1,000
1.4.12	Tarifa të tjera	2,522	8,786	8,461	8,461	9,875	9,895	9,895
1.5	TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	4,865	4,964	7,821	7,821	5,700	5,700	5,700
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	0	0	0	0	0	0	0



1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë	4,865	4,964	7,425	7,425	5,700	5,700	5,700
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	0	0	0	0	0
1.5.5	Shitja e aseteve financiare	0	0	0	0	0	0	0
1.5.6	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0	0
1.5.7	Të tjera	0	0	396	396	0	0	0
1.6	TË TJERA ADMINISTRATIVE	131	1,080	0	0	0	0	0
1.6.1	Kamatëvonesat	30	150	0	0	0	0	0
1.6.2	Gjoha, sekuestime dhe zhvëmtime	101	928	0	0	0	0	0
1.6.3	Të tjera	0	3	0	0	0	0	0
2	TRANSFERTA NGA BUXHETI QËNDROR	337,838	261,981	378,325	378,325	353,346	361,104	369,828
	Burimet Buxhetore	2024 Fakti	2025 Fakti	2026 Plani Fillestar	2026 Plani i Rishikuar	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
2.1	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME	204,617	154,158	216,154	216,154	223,029	230,787	238,208
2.1.1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	204,617	128,102	171,881	171,881	178,756	186,514	193,935
2.1.2	Rritja e nivelit të pagave	0	26,057	44,273	44,273	44,273	44,273	44,273
2.1.3	Fond shtesë nga Kuvendi	0	0	0	0	0	0	0
2.2	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	133,221	102,174	127,761	127,761	130,317	130,317	131,620
2.2.1	Konviktet e arsimit parauniversitar	6,163	5,655	7,467	7,467	7,616	7,616	7,693
2.2.2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimit	34,626	25,896	35,729	35,729	36,444	36,444	36,808
2.2.3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	0	4,969	8,164	8,164	8,328	8,328	8,328



2.2.4	Arsimi parauniversitar	5,127	4,652	7,268	7,268	7,413	7,413	7,487
2.2.5	Mbrojtja nga zjarri	21,223	18,300	25,572	25,572	26,084	26,084	26,344
2.2.6	Mbrojtja sociale	0	0	0	0	0	0	0
2.2.7	Administrimi i pyjeve	7,569	5,615	8,542	8,542	8,713	8,713	8,800
2.2.8	Rrugët	8,397	6,755	8,923	8,923	9,102	9,102	9,193
2.2.9	Ujitja dhe Kullimi	2,963	9,052	12,296	12,296	12,542	12,542	12,668
2.2.10	Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti"	40,090	0	0	0	0	0	0
2.2.11	Menaxhimi i mbetjeve urbane	7,062	21,280	13,800	13,800	14,076	14,076	14,217
2.2.12	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
2.3	TRANSFERA TË KUSHTËZUARA	0	5,649	34,409	34,409	0	0	0
2.3.1	Për funksione të deleguara	0	0	0	0	0	0	0
2.3.2	Për projekte të veçanta	0	5,649	34,409	34,409	0	0	0
	Burimet Buxhetore	2024	2025	2026	2026	2027	2028	2029
		Fakti	Fakti	Plani Fillestar	Plani i Rishikuar	Plani	Plani	Plani
2.4	TRANSFERTE SPECIFIKE	0	0	0	0	0	0	0
2.4.1	Transfer të specifike	0	0	0	0	0	0	0
3	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	11,333	12,969	10,700	10,700	12,700	12,700	12,700
3.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdonara	6,282	6,965	6,200	6,200	8,000	8,000	8,000
3.2	Renta minerare	0	0	0	0	0	0	0
3.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	5,050	6,004	4,500	4,500	4,700	4,700	4,700
3.4	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0



4	GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA	2,423	1,245	22,160	25,938	15,826	0	0
4.1	TRANSFERTA NGA I NJËJTI NIVEL QEVERISJE	0	0	0	0	0	0	0
4.1.1	Transferta nga i njëjti nivel qeverisje	0	0	0	0	0	0	0
4.2	GRANTE TË TJERA TË BRENDSHME	2,423	1,245	15,778	15,778	12,348	0	0
4.2.1	Grante të Tjera të Brendshme	2,423	1,245	15,778	15,778	12,348	0	0
4.3	GRANTE TË HUAJA	0	0	6,382	10,160	3,478	0	0
4.3.1	Grante të huaja	0	0	6,382	10,160	3,478	0	0
5	HUAMARRJA	0	0	0	0	0	0	0
5.1	Huamarrja afatshkurtër	0	0	0	0	0	0	0
	2026 Buxheti	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
Sasia	5	5	5	0
Shpenzime Totale	0	0	0	0
Shpenzime Totale për Njësi	0,000	0,000	0,000	0,000
Ndryshimi në % i Sasisë		0.00%	0.00%	-100.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale				
Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi				
Produkti	V813AAB - Disiplinat e Ndryshme Sportive të Mbështetura			
Përshkrimi i Produktit	Shpenzimet e planifikuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për të mbështetur sportistë, stafet mbështetëse të disiplinave sportive dhe trajtimin financiar të tyre. Sipas disiplinave do të kostohet shpenzimet referuar nevojave për paga, uniforma, dieta etj. Tregues i cili do të paraqitet në sipërfaqen e mjediseve sportive dhe argëtuese të të shtrua në vit. Këto do të përfshihen edhe shpenzimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e terreneve sportive në dispozicion të disiplinave të ndryshme sportive.			
Njësia e Matjes	linje sportesh			
	2026 Buxheti	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
Sasia	4	4	4	3
Shpenzime Totale	6,530	4,000	4,000	4,000
Shpenzime Totale për Njësi	1,632,500	1,000,000	1,000,000	1,333,333
Ndryshimi në % i Sasisë		0.00%	0.00%	-25.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale		-39.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi		-39.00%	0.00%	33.00%

Objektivi i Politikës së Programit	Ob 1.1 - Ofrimi i shërbimit për mbrojtjen e jetes dhe pronës nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore sipas standarteve kombëtare për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi.			
Produkti	V328AAB - Shërbime të Mbrojtjes Civile			
Përshkrimi i Produktit	Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e mbrojtjes civile.			
Njësia e Matjes	numer stafit			
	2026 Buxheti	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
Sasia	14	14	14	14
Shpenzime Totale	24,798	25,842	25,842	25,842

Raporti: PBA7 - Shpenzimet e Produkteve të Programit

NJVQV: 135 - Bashkia Përmet

Programi AD135 - Argëtim dhe

: PBA: 2027-2029



Vlerat paraqiten në: 000

Objektivi i Politikës së Programit	Ob 2.1 - Rritja e ndërgjegjesimit dhe vlerësimit të trashëgimisë kulturore. Rritja e vlerave të trashëgimisë kulturore nepermjet projektit STONE ART.Njohja me trashëgiminë disonante dhe kulturore permes projektit URBACT			
Produkti	V822AAD - Promovimi i trashëgimisë kulturore			
Përshkrimi i Produktit	Shpenzimet për broshura, për pika informimi, shfaqje kulturore dhe artistike për promovimin e trashëgimisë kulturore apo forma të tjera për promovimin e trashëgimisë kulturore brenda territorit të njësive të vetëqeverisjes vendore.			
Njësia e Matjes	numeri			
	2026 Buxheti	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
Sasia	15	15	15	16
Shpenzime Totale	3,268	1,000	1,000	1,000
Shpenzime Totale për Njësi	217.867	66.667	66.667	62.500
Ndryshimi në % i Sasisë		0.00%	0.00%	7.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale		-69.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi		-69.00%	0.00%	-6.00%



Rapórti: PBA7 - Shpenzimet e Produkteve të Programit

NJVQV: 135 - Bashkia Përmet

Programi

: PBA: AD135 - Argëtim dhe

74.000.000,00 2027 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000

Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi	-100.00%		
--	----------	--	--

Raporti: PBA7 - Shpenzimet e Produkteve të Programit

NJVQV: 135 - Bashkia Përmet
 Programi: AD135 - Argëtim dhe
 : PBA: 2027-2029



Vlerat paraqiten në: 000

Objektivi i Politikës së Programit	Ob 5.1 - Sigurimi i ndihmës për familjet dhe individët në nevojë për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Individë që përfitojnë nga projekti KEY PEOPLE, RIWET			
Produkti	V043AAD - Familje dhe Individë në nevojë që Përfitojnë nga Skema e NE			
Përshkrimi i Produktit	Shpenzimet që planifikojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore në buxhetin e tyre për mbështetjen e familjeve dhe individëve në nevojë që përfitojnë nga skemat e Ndihmës Ekonomike.			
Njësia e Matjes	numër			
	2026 Buxheti	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
Sasia	60	66	66	66
Shpenzime Totale	2,300	13,554	13,554	13,554
Shpenzime Totale për Njësi	38.333	205.364	205.364	205.364
Ndryshimi në % i Sasisë		10.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale		489.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi		436.00%	0.00%	0.00%

Objektivi i Politikës së Programit	Ob 1.1 - Përmirësimi i shërbimit të stafit të trashëgimisë kulturore dhe projekteve të lidhura me qëllimin			
Produkti	V822AAA - Shërbimet e Stafit të Trashëgimisë Kulturore, Muzeve, Bibliotekave			
Përshkrimi i Produktit	Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në stafin që mbelen objektet e trashëgimisë kulturore, muzeve dhe bibliotekave të njësitë të vetëqeverisjes vendore.			
Njësia e Matjes	numër stafi			
	2026 Buxheti	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
Sasia	15	15	15	20
Shpenzime Totale	17,514	13,473	13,473	13,473
Shpenzime Totale për Njësi	1,167.600	898.200	898.200	673.650
Ndryshimi në % i Sasisë		0.00%	0.00%	33.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale		-23.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi		-23.00%	0.00%	-25.00%
Produkti	V822AAK - Fuksionimi i Bibliotekës			
Përshkrimi i Produktit	Shpenzimet për mirëmbajtjen, fuksionimin dhe shërbimin e fondit të librave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ofrojnë bibliotekat në territorin e njësitë të vetëqeverisjes vendore.			
Njësia e Matjes	numër			
	2026 Buxheti	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
Sasia	50	50	50	0
Shpenzime Totale	644	0	0	0
Shpenzime Totale për Njësi	12.875	0.000	0.000	0.000
Ndryshimi në % i Sasisë		0.00%	0.00%	-100.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale		-100.00%		

Raporti: PBA7 - Shpenzimet e Produkteve të Programit

NJVQV: 135 - Bashkia Përmet

Programi

: PBA: AC135 - Arsimi dhe Kujdesi

Çelësi: 2027 - 2029



Vlerat paraqiten në: 000

Objektivi i Politikës së Programit	Ob 4.1 - Krijimi i ambienteve mesimore argetuese e clodhese per femijet e QKPF			
Produkti	V912AAF - Fëmijë që Frekuenzojnë Qendrat Kulturore të Fëmijëve			
Përshkrimi i Produktit	Shpenzimet për funksionimin e qendrave kulturore të fëmijëve në njësitë e vetëqëveshjes vendore ku përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin (materiale për kurse, ujë, energji elektrike, ngrohje, etj.) e këtyre qendrave, pagesat për ekspertët e jashtëm, zhvillimin e kurseve të ndryshme të baletit, kitarës, pikantës, etj.			
Njësia e Matjes	numër			
	2026 Buxheti	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
Sasia	25	25	25	25
Shpenzime Totale	555	555	555	555
Shpenzime Totale për Njësi	22.200	22.200	22.200	22.200
Ndryshimi në % i Sasisë		0.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale		0.00%	0.00%	0.00%
Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi		0.00%	0.00%	0.00%

P912AAU	Rikonstruksion i Shkolles 9-vjecare Meleq Gosnishti	Financim i Brendshëm	01-01-2025	31-05-2026	938	0	0	938	0	0	0
P452AAK	Sistemim asfaltim në rrugë të ndryshme të bashkisë	Financim i Brendshëm	01-01-2026	31-12-2029	122,923	0	0	12,695	19,805	24,939	65,484
P452-PE-004	Projektim Sistemim Asfaltim Rruga e Fshatit Pacomit	Financim i Brendshëm	01-01-2027	31-12-2027	3,000	0	0	0	3,000	0	0
P452-PE-005	Sistemim Asfaltim Rruga e Fshatit Pacomit	Financim i Brendshëm	01-01-2027	31-12-2028	55,000	0	0	0	23,178	31,822	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Projekteve					324,136	0	0	127,788	73,666	56,979	65,703
Shpenzimet Kapitale sipas Produkteve											
KODI	EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT	BURIMI I FINANCIMIT	DATA E FILLIMIT	DATA E PËRFUNDIMIT	KOSTO TOTALE	2024 FAKTI	2025 FAKTI	2026 BUXHETI	2027 PLANI	2028 PLANI	2029 PLANI
V626AAD	Sipërfaqe e Gjelbëri e Mirëmbajtur dhe Rehabilituar					0	0	120	0	0	0
V822AAK	Funksionimi i Bibliotekës					0	0	600	0	0	0
V452AAC	Rrjet Rrugor Rural i Rehabilituar					0	0	500	0	0	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Produkteve						0	0	1,220	0	0	0
Totali i Përgjithshëm						0	0	129,008	73,666	56,979	65,703





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ Prot.

Përmet, më ____ . ____ .2026

P/VENDIM

Nr. ____ datë ____ . ____ .2026

PËR ZBATIMIN E VKM-SË NR 87, DATË 06.02.2026 PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR 326, DATË 31.05.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHIME NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE" TË NDRYSHUAR

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 5 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", pika ç, VKB NR.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi të saj, i ndryshuar, VKM-së nr 87, datë 06.02.2026 Për disa ndryshime në Vendimin nr 326, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike" të ndryshuar, pika nr 1 lidhja nr 2, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtat numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

VENDOSI:

I. Të miratojë ndryshimet e përcaktuara në Vendimin nr 87, datë 06.02.2026 për pozicionin Sekretar shkolle sipas lidhjes nr II.

II. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

III. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen prej datës 01.01.2026 .

KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

RELACION PËR P/V: PËR ZBATIMIN E VKM-SË NR 87, DATË 06.02.2026 PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR 326, DATË 31.05.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", pika ç, VKB NR.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi të saj, i ndryshuar, VKM-në nr 87, datë 06.02.2026 Për disa ndryshime në Vendimin nr 326, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike" të ndryshuar, pika 1 Lidhjet nr.1 dhe 2, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtat numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Përmbledhje Ekzekutive

Ky Projekt-Vendim paraqitet për miratim me qëllim aprovimin e VKM-se nr 87 date 06.02.2026.

Arsyetimi

Duke qene se ky Vendim eshte miratuar nga Këshilli i Ministrave, kerkojme njohjen dhe zbatimin e tij nga Keshilli Bashkiak dhe Bashkia Permet.

Analiza financiare dhe Buxhetore

Nga ana e Bashkisë Përmet është dërguar shkresa me nr 1664 prot, date 07.05.2026 me lende "Kërkese për burime shtese drejtuar Ministrise se Financave, Ministrise se Arsimit dhe Sportit, te cilat jane shprehur se nuk disponojne fonde të pashperndara per njesite e veteqeverisjes vendore per vitin 2026 dhe per kete arsye keto shtesa do te mbulohen nga ana jone ne ndryshimet buxhetore qe do te behen ne vazhdimesi.

Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen prej dates 01.01.2026

Konkluzione dhe Rekomandime

Per sa me siper i kerkojme Këshillit Bashkiak :



Udhëzime miratohet ndryshimet e përcaktuara në Vendimin nr 87, datë 06.02.2026 për pozicionin
Miratohet shkollë sipas lidhjes nr II me nr rendor 8 dhe klasë page VIII.

	Emertimi i pozicionit te punes	Paga e pozicionit (Ishte)	Paga e pozicionit (Bëhet)
I	Sekretar Gjimnazi	44.100	54.100

Dokumentet Bashkëlidhur
Projekt Vendimi

Konceptoi: K. Çipi
Miratoi: Z. Jace





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2026

PËR

"PËRDORIMIN E FONDIT PËR EMERGJENCAT CIVILE"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit Nr. 10296 dt.8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin,i ndryshuar, Ligjit Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",i ndryshuar, Ligjit Nr. 87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026", Vendimin e KB Nr.113 datë 17.12.2025 "Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2026",i ndryshuar,Ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile",VKM-së Nr.414 datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"e ndryshuar,VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore",VKB-së Nr.91 datë 22.10.2025 "Për miratimin e "Planit Vendor për Emergjencat Civile Bashkia Përmet 2025-2028",në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Nr.6 datë 09.01.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimi i ujrave dhe masive inertesh në Bashkinë Përmet" dhe Urdhrit Nr.14 datë 15.01.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimi i ujrave dhe masive inertesh në Bashkinë Përmet" si dhe bazuar në shkresën Nr.429/6 prot. datë 15.04.2026 të Ministrisë së Mbrojtjes mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile dhe në kërkesat e disa qytetarëve në Bashkinë Përmet për konstatim dhe vlerësim dëmi, në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë ,

VENDOSI:

1. Të miratojë përdorimin e fondit nga emergjencat civile për 8 (tetë) familje të prekura në vlerën 1 050 599.1 (një milionë e pesëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë një) lekë, sipas kreut III,pika 3 shkronja ç të VKM Nr.329/2012.
2. Fondet për mbulimin e këtyre shpenzimeve do të përballohen nga struktura buxhetore :
 - 17.10910.01.604.91707AB në vlerën 1 050 599.1 (një milionë e pesëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë një) lekë, për 8 (tetë) familjet të paraqitura në tabelën si më poshtë :

Nr.	EMËR/MBIEMËR	VLERA TOTALE SIPAS PREVENTIVIT	MASA E NDIHMËS FINANCIARE
1	ESAT HARKA	123 071.76	61 535.88
2	ARBEN ISUFI	644 154.34	322 077.17
3	XHEMAL CANO	663 519.79	331 759.895
4	THOMA ZHULATI	120 618.16	60 309.08
5	NAPOLON TICE	151 031.95	75 515.975
6	SOSE DHËMBI	51 352.34	25 676.17
7	YZEIR NIKOLLARI	117 027.59	58 513.795
8	VJOLLCA KUKURECI	230 422.27	115 211.135
	TOTALI	2 101 198.2	1 050 599.1

- Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Buxhet-Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile.
- Ky vendim, pas miratimit nga ana e këshillit Bashkiak Përmet, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



RELACION
PËR
"PËRDORIMIN E FONDIT PËR EMERGJENCAT CIVILE "

Përmet, më _____, _____ 2026

1. Titulli dhe Referencat Administrative

Projekt-vendimi "Për përdorimin e fondit për emergjencat civile" paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak Përmet, në mbështetje të legjislacionit në fuqi, konkretisht:

- a) Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.
- b) Ligjit Nr. 10296 dt.8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin,i ndryshuar.
- c) Ligjit Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",i ndryshuar.
- d) Ligjit Nr. 87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026".
- e) Vendimin e KB Nr.113 datë 17.12.2025 "Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2026",i ndryshuar.
- f) Ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile".
- g) VKM-së Nr.414 datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"e ndryshuar.
- h) VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".
- i) VKB-së Nr.91 datë 22.10.2025 "Për miratimin e "Planit Vendor për Emergjencat Civile Bashkia Përmet 2025-2028".
- j) Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Nr.6 datë 09.01.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimi i ujrave dhe masive inertesh në Bashkinë Përmet".
- k) Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Nr.14 datë 15.01.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimi i ujrave dhe masive inertesh në Bashkinë Përmet".
- l) Shkresa Nr.429/6 Prot. datë 15.04.2026 e Ministrisë së Mbrojtjes,Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

2. Përmbledhje Ekzekutive

Ky projekt-vendim synon miratimin e përdorimit të fondit të emergjencave civile për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore në territorin e Bashkisë Përmet. Nëpërmjet këtij akti propozohet mbështetja financiare për 8 (tetë) familje të prekura, në bazë të vlerësimeve të kryera nga grupet e punës së ngritura për këtë qëllim.

Qëllimi kryesor është ofrimi i ndihmës së menjëhershme dhe lehtësimit i pasojave ekonomike për familjet e dëmtuara, duke garantuar reagim institucional në përputhje me kuadrin ligjor për emergjencat civile.

3. Arsyetimi dhe nevoja për aktin

Gjatë periudhës së fundit, në territorin e Bashkisë Përmet janë evidentuar situata emergjente si pasojë e vërshimit të ujërave dhe depozitimit të masiveve inerte, të cilat kanë shkaktuar dëme në banesa dhe pasuri të qytetarëve.

Grupet e punës të ngritura me urdhër të Kryetarit të Bashkisë kanë kryer verifikimet në terren dhe kanë hartuar aktet përkatëse të konstatimit dhe vlerësimit të dëmeve, mbi bazën e të cilave rezulton nevoja për ndërhyrje financiare.

Mosmiratimi i këtij akti do të sillte pasoja sociale dhe ekonomike për familjet e prekura, duke rritur vështirësitë për përballimin e dëmeve dhe duke ulur efektivitetin e reagimit institucional në raste emergjencash.

4. Përputhshmëria me dokumentet strategjike

Ky projekt-vendim është në përputhje të plotë me:

- Planin Vendor për Emergjencat Civile 2025–2028 të Bashkisë Përmet;
- Buxhetin e miratuar të vitit 2026;
- Politikat kombëtare dhe vendore për menaxhimin e emergjencave civile dhe mbrojtjen e qytetarëve.

Ai kontribuon në realizimin e objektivave për rritjen e sigurisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive natyrore.

5. Analiza Financiare dhe Buxhetore

Vlera totale e fondit të parashikuar për këtë qëllim është:

1 050 599.1 (një milionë e pesëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë një) lekë.

Në zbatim të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, sipas kreut III,pika 3 shkronja ç të VKM Nr.329/2012 mbi masën e ndihmës financiare për dëmtime individuale ose në grupe të vogla banesash, përcaktohet se ndihma financiare jepet nga njësitë e qeverisjes vendore nëpërmjet programit buxhetor "Emergjencat Civile" dhe llogaritet në masën 50% të vlerës së përlllogaritur të dëmit, sipas metodologjisë ligjore në fuqi.

Bazuar në preventivat dhe aktet e vlerësimit të hartuara nga grupet e punës, vlera totale e dëmeve të konstatuara rezulton në shumën 2,101,198.20 (dy milionë e njëqind e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë dy) lekë.

Në zbatim të dispozitës së sipërcituar, masa e ndihmës financiare që propozohet për miratim nga Këshilli Bashkiak Përmet përlllogaritet në masën 50% të vlerës totale, konkretisht:

Vlera totale sipas preventivave: 2,101,198.20 (dy milionë e njëqind e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë dy) lekë.

Masa e ndihmës financiare (50%): 1,050,599.10 (një milionë e pesëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë një) lekë.

Përlllogaritja është kryer në respektim të kriterëve dhe procedurave ligjore në fuqi për trajtimin e rasteve të emergjencave civile dhe mbështetet në dokumentacionin teknik e financiar bashkëlidhur projekt-vendimit.

Ky fond do të përballohet nga zërat përkatës të buxhetit të Bashkisë Përmet për emergjencat civile, në përputhje me strukturën buxhetore të miratuar.

Ndikimi financiar është i përballueshëm dhe i planifikuar brenda kufijve të buxhetit vjetor, pa krijuar detyrime shtesë financiare.



Nr.	EMËR/MBIEMËR	VLERA TOTALE SIPAS PREVENTIVIT	MASA E NDIHMËS FINANCIARE
1	ESAT HARKA	123 071.76	61 535.88
2	ARBEN ISUFI	644 154.34	322 077.17
3	XHEMAL CANO	663 519.79	331 759.895
4	THOMA ZHULATI	120 618.16	60 309.08
5	NAPOLON TICE	151 031.95	75 515.975
6	SOSE DHËMBI	51 352.34	25 676.17
7	YZEIR NIKOLLARI	117 027.59	58 513.795
8	VJOLLCA KUKURECI	230 422.27	115 211.135
	TOTALI	2 101 198.2	1 050 599.1

6. Konsultimi dhe përfshirja e palëve

Ky projekt-vendim bazohet në kërkesat e paraqitura nga qytetarët e dëmtuar dhe në verifikimet e kryera nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë.

Procesi i vlerësimit është realizuar nga ekspertë dhe grupe pune të specializuara, duke garantuar transparencë dhe objektivitet.

7. Konkluzione dhe Rekomandime

Në përfundim, vlerësohet se miratimi i këtij projekt-vendimi është i domosdoshëm dhe i justifikuar, pasi:

- adreson një situatë emergjente reale;
- mbështet drejtpërdrejt familjet e prekura;
- është në përputhje me kuadrin ligjor dhe financiar në fuqi.

Rekomandohet miratimi i projekt-vendimit nga Këshilli Bashkiak Përmet.

8. Dokumentet bashkëlidhur

- Kërkesat e qytetarëve;
- Foto të banesave, ku evidentohen problematikat;
- Proces-verbale konstatimi të dëmtimeve/gjendjes së banesave;
- Proces-verbale vlerësimi & Preventiv Punimesh;
- Kopje të dokumentit të pronësisë;

Duke ju falenderuar !

Konceptoi : **Bekim MECANI** (Përgjegjës i Emergjencave Civile)





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr _____ Prot

Datë _____, _____, 2026

Për

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin Nr. 68 /2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Ligji Nr.87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026", Vendimi i KB Nr.113 datë 17.12.2025 "Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2026" dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj", Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara (për dhënie ndihme financiare) në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë. për sa më poshtë vijon:

- 1 Altin Dhamo të ndimohet përkatësisht në shumën 20.000 (njëzetë mijë) lekë.
- 2 Liri Sotiri të ndimohet përkatësisht në shumën 20.000 (njëzetëmijë) lekë
- 3 Viktor Proko të ndimohet përkatësisht në shumën 20.000 (njëzetë mijë) lekë.
- 4 Robert Miti të ndimohet përkatësisht në shumën 20.000 (njëzetë mijë) lekë.
- 5 Namik Muço të ndimohet përkatësisht në shumën 20.000 (njëzetë mijë) lekë.
- 6 Fidije Bregu të ndimohet përkatësisht në shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

- 2 Miratimin e transferimit buxhetor si më poshtë :

Pakësim në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 05,ART 609.Kod Produkti V494AAA në shumën 200.000 lekë



Shënimi në strukturën buxhetore :

GR 00,TTT AF135,KAP 05,ART 606,Kod Produkti V494AAA në shumën 200.000 lekë

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Financës dhe Tatim –Taksa/Sektor i Buxhet Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA

Alma Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më ____ . ____ . 2026

RELACION
DREJTUAR
KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë!

Shtetësi Altin Dhamo, banuese në fshatin Lipë, Njësia Administrative Petran, Përmet ka bërë kërkesë Nr.1856 Prot datë 25.05.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi është në kushte shumë të vështira ekonomike, i divorcuar me një fëmijë për përkujdesje dhe nuk i mjaftojnë të ardhurat për rritjen dhe edukimin e vajzës së tij.

Pranë bashkisë është paraqitur kërkesë me Nr.1833 Prot datë 25.05.2026 nga shtetësja Liri Sotiri banues në Përmet e cila kërkon të ndimohet financiarisht nga bashkia pasi ka djalin ,nusen dhe nipin të pa punë dhe nuk i përballon dot shpenzimet mujore me pensionin që merr.

Edhe shtetasi Viktor Proko banues në Njësinë Administrative Petran, Përmet ka paraqitur kërkesë Nr.1834 Prot datë 25.05.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi është person, pa punë, në kushte të vështira ekonomike i sëmurë, i pa aftë mendërisht nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të përballuar jetesën dhe shpenzimet për marrjen e ilaçeve të tij.

Shtetësi Robert Miti banues në Përmet ka paraqitur kërkesë Nr.1582 Prot datë 28.04.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi ka bërë një ndërhyrje kirurgjikale dhe nuk ka të ardhura për të përballuar shpenzimet për blerjen e ilaçeve dhe jetesën.

Shtetësi Namik Muço banuese në Përmet ka paraqitur kërkesë Nr.1683 Prot datë 08.05.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi është i sëmurë ,me problem të shëndetit mendor, me KEMP dhe nuk ka të ardhura për të përballuar jetesën.

Njëkohësisht edhe shtetësja Fidije Bregu ka paraqitur kërkesë Nr. 1970 Prot datë 04.06.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi bashkëshorti i saj Ervis Bregu pësoi një aksident tragjik duke punuar në fshatin Grabovë.(I plasi nje bombë).

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore " ,Ligjin Nr. 68 /2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore ",Ligjin 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë "i ndryshuar,Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Ligji Nr.87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026" ,VKB Nr.113 datë 17.12.2025 " Për miratimin e buxhetit të



Bashkisë për vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj, kërkojmë që :

- | | | |
|-----------------|------------------------------------|-------------------------------|
| 1- Altin Dhamo | të ndimohet përkatësisht në shumën | 20.000 (njëzetë mijë) lekë. |
| 2- Liri Sotiri | të ndimohet përkatësisht në shumën | 20.000 (njëzetë mijë) lekë |
| 3- Viktor Proko | të ndimohet përkatësisht në shumën | 20.000 (njëzetë mijë) lekë. |
| 4- Robert Miti | të ndimohet përkatësisht në shumën | 20.000 (njëzetë mijë) lekë. |
| 5- Namik Muço | të ndimohet përkatësisht në shumën | 20.000 (njëzetë mijë) lekë |
| 6- Fidije Bregu | të ndimohet përkatësisht në shumën | 100.000 (njëqind mijë) |
| | lekë. | |

Bashkengjitur i gjithë dokumentacioni përkatës.

Drejtori Shërbimit Social

Arjana PAPAPANO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ Prot.

Datë _____. _____. 2026

P/VENDIM

Për dhënie titulli " Qytetar Nderi i Përmetit"

Në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" Neni 54 pika m,Neni 55 e në vijim, Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,Vendimi Nr.2 datë 08.01.2026 i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, Ligji Nr.94/2022 " Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë,nenet 8 e në vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" Këshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë.

VENDOSI

1 – T'i japë titullin "Qytetar Nderi i Përmetit"

Shënjtërisë së Tij Z. Haxhi Dede Edmond Brahimaj,Kryegjysh Botëror i Bektashinjve Tiranë.

me motivacionin :

" Për kontribut të shquar në shërbim të paqes,harmonisë ndërfetare,vlerave kombëtare dhe shoqërisë shqiptare,për përkushtimin e palodhur në forcimin e unitetit kombëtar dhe bashkëjetesës pa dallim feje,për përfaqësimin e Shqipërisë dhe të komunitetit bektashian në arenën ndërkombëtare si dhe për lidhjen e veçantë me trevën e Përmetit duke kontribuar në promovimin e vlerave që e karakterizojnë këtë komunitet duke shërbyer si model frymëzimi për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

2- Ky vendim shpallet brenda 10 ditëve nga data e miratimit.

KRYETARI

Alma HOXHA



Sheshi "Abdyl Frashëri",tel.+35581322254; bashkiapërmet.gov.al; e-mail: info@bashkiapërmet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA PËRMET

Përmet më __. __. 2026

RELACION

Drejtuar : Këshillit Bashkiak
Lënda : Propozim për dhënie titulli "Qytetar Nderi "

Me propozim të Kryegjyshitës Botërore Bektashiane Tiranë, Teqeja Alipostivan Frashër Përmet, Shoqatës Atdhetare kulturore Mbarëkombëtare " Vëllezërit Frashëri "Përmet dhe kryetares së bashkisë Përmet znj. Alma Hoxha është paraqitur para Jush dokumentacioni dhe relacioni përkatës për dhënie titulli "Qytetar Nderi" i Përmetit për Shënjtërinë e Tij z. Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryegjysh Botëror i Bektashinjve Tiranë.

Po japim më poshtë një përshkrim të shkurtër për jetën dhe veprën e Shënjtërisë së Tij z. Haxhi Dede Baba Edmond Brahimaj.

Haxhi Dede Edmond Brahimaj lindi në 19 Maj në vitin 1959 në Tiranë nga një familje me ndjenja të theksuara dhe besimtarë të devotshëm të bektashizmit me origjinë nga fshati Brataj-Vlorë.

Pasi mbaroi shkollën 8-vjeçare vazhdoi studimet në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" me rezultate të larta dhe më vonë ndjek studimet e larta në Akademinë e Forcave Tokësore sot " Akademia Skënderbej ". Nga viti 1982-1990 ka shërbyer në funksione të ndryshme ushtarake si në Burrel, peshkopi dhe Librazhd. Me ringjalljen e besimit bektashian në fund të viteve 90 së bashku me klerikë dhe besimtarë të tjerë merr pjesë në Këshillin Organizativ të Selisë së Shenjtë të Kryegjyshitës Botërore Bektashiane për rihapjen e saj.

Jeta dhe vepra e z. Haxhi Dede Baba Edmond Brahimaj është shumë e pasur si për veprimtarinë e Tij në ringritjen e besimit bektashian ashtu edhe në jetën letrare duke botuar disa libra për përhapjen e fesë bektashiane

Në fillim të vitit 1991 me kërkesën e tij lirohet nga funksioni ushtarak duke marrë përsipër barrën për organizimin e Komunitetit Bektashian. Vlen të theksojmë se edhe në kushtet më të vështira, atëhere kur ushtrimi i besimit fetarë në Shqipëri u ndalua me nen të veçantë të Kushtetutës, shtëpia e prindërve të tij në Tiranë ka shërbyer për mbajtjen gjallë të bektashizmit duke u rrezikuar shumë prej regjimit që nuk falte. Më dy janar të vitit 1992 mer dorë tek udhëheqësi i tij shpirtëror, Haxhi Dede Reshat Bardhi dhe Baba Barjam Mahmutaj, duke u inkuadruar kështu përfundimisht në rrugën e Pirit të ndritur Haxhi Bektash Veliut. Këtu zë fill kariera e tij fetare. Më 16 maj 1996 konsakrohet me urdhrin "Dervish", menjëherë ngarkohet me detyrë në Gjyshitën Bektashiane Korçë, në teqenë e Turanit.

Puna e palodhur e tij për kontinutetin dhe ringritjen e besimit bektashian në Librazhd, Pogradec, Mokër, Korçë, Devoll dhe Kavajë, bëri që më 13 prill të vitit 1997, dekretohet me



titullin "Baba" dhe pas kalimit nga kjo jetë e baba Bajram Mahmutaj caktohet si zëvendës i pastri i Kryegjyshit Botëror Bektashian Haxhi Dede Reshat Bardhi. Në këtë funksion të lartë kontributi i tij ka qënë i çmuar sidomos në ideimin, përgatitjen dhe realizimin e tri kongreseve radhës të bektashizmit.

Madje në dy kongreset e fundit (Tiranë 2000 dhe 2005) ka raportuar në cilësinë e përgjegjësit të Këshillit të Lartë Gjyshëror.

Në marsin e vitit 2006, me kalimin nga jeta të Baba Tahir Eminit, gjithashtu emrohet në funksionin e gjyshit të gjyshatës bektashiane në Maqedoni. Kontributi i tij në këtë gjyshatë ka qënë sa në rrafsh të organizimit të komuniteteve të besimtarëve atje, edhe në aspektin e njohjes prej ndërkombëtarëve. Si në Korçë edhe në Tetovë Haxhi Baba Edmond Brahimaj ka manifestuar cilësitë e spikatura të klerikut bektashian në aspektin doktrinor, moral dhe qytetar duke u shndëruar në faktorin të tolerancës fetare midis besimeve të tjera. Në vitin 2004 për kontributin e çmuar të tij Këshilli Bashkiak i Qarkut të Korçës e ka nderuar me titullin më të lartë

"Nderi i Qarkut të Korçës".

Ai ka marrë shumë falenderime dhe konsiderata të larta prej qeverive të Shqipërisë dhe Maqedonisë, shoqatave civile, gjithashtu trupi diplomatik i akredituar në Shkup ka vlerësuar lartë si njeri me të gjitha atributet e një prijësi fetar, posaçërisht roli i tij paqësor në Harabati Baba, teqe në Tetovë dhe mënyra e tij, si përballej me diskriminimin ligjor ndaj Komunitetit Bektashian, duke përdorur urtësinë, zgjuarësinë dhe mbetet njeriu me fjalët e urta dhe të ëmbëla.

Që nga viti 1992 e në vazhdim Haxhi Baba Edmond Brahimaj ka marrë pjesë në trajnime të organizatave prestigjioze ndërkombëtare, kurse doktrimore, simpoziume dhe veprimtari të ndryshme me karakter fetar, human dhe social, ku edhe ka referuar duke çuar aty zërin dhe eksperiencat e komuniteteve bektashiane të kudondodhura në botë. Kështu më 1996 referoi në Teheran lidhur me tolerancën bektashiane në trevat e Ballkanit. Më 14 qershor 2003, në Konferencën Ndërkombëtare "Fetë dhe Civilizimet në mijvjeçarin e ri" referon rreth sfidave të bektashizmit në të ardhmen. Në qershor 2004 me kuadër të trajnimeve të organizatës të Komuniteteve fetare tradicionale shqiptare, viziton shtëpinë e Bardhë në SHBA. Nga bordi i kësaj

organizate ka merituar titullin "Ambasadori i Paqes". Ka shkuar në SHBA nga Departamenti I Shtetit dhe nga ambasada amerikane në Shqipëri për një periudhë 21 ditore për diversitetin e fesë në SHBA. Ka marrë pjesë disa herë në festimet e 16 gushtit në Haxhi Bektash të Turqisë, ku është pritur nga drejtues të lartë të shtetit turk si edhe ata të Institutit "Haxhi Bektash Veliut" pranë Universitetit të Gazit në Turqi. Gjithashtu ka qënë i pranishëm dhe ka kontribuar me ligjëratat e tij në veprimtari analoge në Tiranë, Shkup, Prishtinë, Ohër, Stamboll, Ankara,

Afiyon, Shtutgart Keln, dhe në Detroit të SHBA -ës. Pjesëmarrës në pelegrinazhin Botërore për Haxhillëk në Mekë, vitin 2004. Merr pjesë në vizitat e vendeve të shenjta në Jeruzalem në Izrael, në vitin 2007. Ka qënë i ftuar në Kongresin e 33 Botëror për "Liritë Fetare" në Indi dhe ka ndezur pishtarin të këtij aktiviteti së bashku me udhëheqësin e shquar fetar Dalai Lama. Ka marrë pjesë në tri konferenca Botërore mbi fenë në Maqedoni nga viti 2006-2011. Është në vitin e fundit të studimeve për Juristikën në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Maqedoni.

Pas kalimit nga jeta e ish Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, Haxhi Dede Reshat Bardhit, baba Mondit më 11.06.2011 zgjidhet në postin e lartë të Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve. Këto vite si Kryegjysh Botëror i Bektashinjve, Hirësija e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ka punuar me përkushtim duke vazhduar rrugën e Dede Reshatit Bardhit, traditën bektashiane në mardhënie institucionale brenda dhe jashtë vendit. Ka patu gjatë kësaj periudhe drejtimi një axhent të ngjeshur në veprimtari të ndryshme ndërkombëtare nëpër



botë.Në vendet e Ballkanit ka patur mjaft takime me presidentët e Kryeministrat të Turqisë, Bullgari, Rumani, Hungari, Greqi, Maqedoni, Kroaci, Slloveni, Bosnjë-Hercogovinë, Kosovë. Por takimet nga më kryesoret janë: Takimi me përfaqësuesit e Këshillit të Evropës për shtetet fetare në vitin 2012. Takimi me personalitete të lartë të Turqisë, Kryeministrin Erdogan, Presidetin turk dhe përfaqësuesit të lartë të Komunitetit Mysliman të Turqisë në vitin 2013. Pjesëmarrës në Konferencën për 100 vjetorin e Shoqërisë "Vatra" në vitin 2013, takim me personalitete të Shtëpisë së Bardhë në SHBA me sekretarin e Shtetit Xhon Kerri më 2013, Konferenca Botërore për paqe në Pejë të Kosovës, viti 2013. Vizitë në vendet e shenjta të Irakut në qytetin Nexhef, Qerbela, Kufe, Bagdat, prill 2014. Merr pjesë në Samitin për paqen në Seul shtator 2014. Takimi me Papa Françesku në Tiranë 21 shtator 2014. Në veprimtarin ndërkombëtare për një paqe mes popujve 9-12 tetor 2014, Palermo-Itali. Mori pjesë në Marshimin e Bardhë me përfaqësues të katër komuniteteve fetarë të Shqipërisë në Parisë të Francës, në janar të vitit 2015 për masakrën Sharli Ebdo. Bëri të mundur për të realizuar amanetin e Dede Reshat Bardhi në përfundim madhështor të Kryefaltores Bektashiane në Tiranë me pjesëmarrje nga personalitete nga shumë vende të botës më 7 shtator të vitit 2015. Takimi me Papa Françesku më 10 maj, 2016 në Vatikan. Më 17 qershor 2016 mer pjesë në inaugurimin e bustit të "Nënë Terezës, në provincë të Mynihut, organizim i Shoqatës Kulturore "Sali Çekaj", 4 shtator 2016 mer pjesë në Shenjtimin e Nënë Terezës, në Romë-Itali. Takimi me Patriakun Ekumenik i Stambollit, Bartolomeu i Parë në Stamboll të Turqisë shtator 2016 dhe Akademia Botërore e Paqes të OKB i jep titullin "Doctor Honoris Causa". Më 9 tetor 2016 mer pjesë në ceremoninë e shpalljes "Kardinal" të shqiptarit të përvuajtur Dom Ernest Troshanit. 22 mars 2017, "Dita e Sulltan Nevruzit" manifestim madhështor ndërkombëtar sipas rritualeve bektashiane, e ndjekur nga 27 televizione nga vende të ndryshme të botës. Më 25 maj 2017 është organizatori i vitit të dytë "Ditën e Kulturës Bektashiane" në Paris të Francës. Në Qershor të vitit 2017 mer pjesë në "Mëngjesi i lutjeve" Berlin të Gjermanisë. Po këtë muaj organizon veprimtarinë madhështore të 500 vjetorit të veprës Ballëm Sulltanit Pirit të Dytë të bektashizmit, Tiranë-Martanesh. Shtator 2017 mer pjesë në Konferencën e tretë të liderëve fetarë për paqen botërore në Seul të Koresë së Jugut. 14 tetor në Shkup të Maqedonisë organizator i Konferencës Ndërkombëtare me temë: "The Bektashi religious community under premime" relator dhe i ftuar nderi ka marrë pjesë Josef Èinerholster, nën kryetar i Parlamentit European. Tetor 2017 takim në Bruksel për problemin e teqesë Harabati Baba të Tetovës me anëtarë e PE dhe Reporterin e BE-s për Shqipërinë, Knut Fleckentein. Pjesëmarrja e tij në Konferencën Ndërkombëtare rreth religjioneve, kulturës pluraliste për paqen e qëndrueshme në Lindjen e Mesme, Athinë Greqi 30 tetor 2017. Nëntor 2017 mer pjesë në ceremoninë e ngritjes së bustit të "Nënë Terezës" në Kroaci, së bashku me Presidentin e Republikës së Shqipërisë Në Janar 2018 mer pjesë në Berlin në Konferencën Ndërkombëtare "Iraku pas fitores mbi shtetin islamik", organizuar në bashkëpunim me zyrën e Evropës të dialogut midis feve. 7 shkurt 2018 është organizator i jubileut të 480 vjetorit të themelimit të teqesë Harabati Baba, Tetovë -Maqedoni, pjesëmarrje nga ambasadat e akredituara në Maqedoni, përfaqësues të OSBE-s, intelektual, profesore nga vende të Ballkanit dhe Shqipëria.

Ka marrë tituj nderi:

- "Ambasador i Paqes", 2004 - "Nderi i Qarkut të Korçës", 2004. - "Qytetar Nderi" i Komunës Zerqan-Bulqizë., 10 qershor 2014 - "Qytetar Nderi" i Komunës Martanesh-Bulqizë.,

E SHOIR
1971

29qershor 2014 -"Qytetar Nderi" i Komunës Bogovë-Skrapar, 22 gusht 2014 -"Qytetar Nderi" i Komunës Frashër-Përmet, 25 maj 2014. -"Personalitet i shquar i Labërisë, Shoqata "Labëria",shkurt 2015 -"Qytetar Nderi" i Qarkut te Fierit, mars 2015. -"Qytetar Nderi i Qarkut te Beratit, maj 2015. -Urdheri " Kalorsi i Skenderbeut" 7 shtator 2015 nga Presidenti i Republikës. -"Dr. Honorus Causa", Misioni OKB, shator 2016 -Nderi i Bashkisë Bulqizë, tetor 2016 -Mirënjohje nga Presidentin Obama SHBA, janar 2017. -Çmimin e Arit" Ikona e Paqes" Shoqata e Kombeve të Bashkuara, "G.O.D Awards" tetor 2017. -"Qytetar Nderi" i Skraparit, Bashkia Skrapar, janar 2018. -Më 26 qershor 2019 Dr. Munr Kazmir, nënkryetar i Kongresit të Hebrenjve, dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë nderoi dhe dhuroi në shenjë mirënjohjeje Shenjtërinë e Tij dhe Komunitetin Bektashi, Flamurin Amerikan. Për kontributin e shquar në përhapjen e fjalës së Zotit dhe vlerave më të larta mes njerëzve. -Në janar 2021, Shenjtëria e Tij drejtoi Kryesinë e Këshillit Nderfetar të Shqipërisë. Në mandatin si Kryetar i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë dekorohet me medaljen e lartë "Nderi I Kombit" . Presidenti i Republikës, ka dekoruar me dt. 22 mars 2021 me medaljen e lartë "Nderi i Kombit" Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë. Dekorata e lartë "Nderi I Kombit", u dha me motivacionin: "Në vlerësim të kontributit të gjithanshëm në ruajtjen dhepromovimin e frymës së harmonisë, mirëkuptimit e bashkëjetesës midis feve në Shqipëri. Për mesazhet e qarta drejtuar besimtarëve e politikës shqiptare që të synojnë paqen, bashkimin, përparimin e orientimin drejt vlerave atdhetare për një jetë të përbashkët e optimiste; si dhe për rolin e rëndësishëm në lartësimin e modelit shqiptar të dialogut ndërfetar në arenën ndërkombëtare". -Haxhi Dede Edmond Brahimaj nderohet me çmimin: "Unaza e Tolerancës" në Gjermani nëntor 2021. Akademia e Evropiane e Shkencave pranë Universitetit Teknik të Kolnit në Gjermani i ka akorduar H. Dede Edmond Brahimajt, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve dhe njëkohësisht Kryetar i Këshillit Ndërfetar për vitin 2021, Çmimin "Unaza e Tolerancës"me motivacionin, përpërpjekjet dhe mundimet e vlefshme në angazhimet për paqen dhe nxitjen e dialogut ndërfetar, si shembull i veçantë dhe i denjë për tu ndjekur në të ndërtimin, promovimin dhe mbrojtjen e tolerancës; Ceremonia e dhënies së çmimit u zhvillua në ambientet e Akademisë Evropiane të Shkencave pranë Universitetit të Kolnit në Gjermani, ku merrnin pjesë personalitete akademike dhe fetare. - 2022 i jepet titulli "Nderi i Shoqates Labëria"; -Shkurt 2023 i jepet titulli "Nderi i Qarkut Vlorë"; -2023, "Nderi i Qarkut Gjirokastrë" dhe "Qytetar Nderi i qytetit Tepelenë"; -Nentor 2023 Shoqata Ndërkombëtare E Policisë (Ipa) i Akordon Kryegjyshit Botëror, Shenjtëria E Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj Titullin: 'Nderi i Ipa Section – Albania' -Maj 2024 "Qytetar Nderi i qytetit të Librazhdit"; -Dhjetor 2024 i jepet titulli "Nderi i Shoqatës Tomorri"; -16 Janar 2025 Takim me Papa Françeskun në Vatikan dhe nënshkrimi i marrveshjes dypalëshe; Vëllazëria në Humanizëm; të Abu Dhabit e shumë veprimtari të tjera.

Bashëngjitur gjithë dokumentacioni përkatës

Drejtori Shërbimit Social
Arjana PAPANANO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KRYETARI

P/VENDIM

Nr. ___ datë ___ / ___ 2026

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AMBIENTEVE TË QENDRËS DITORE PËR MOSHËN E
TRETË DHE OFRIMIN E SHËRBIMEVE PRANË TYRE**

Në mbështetje të nenit 24 dhe 54, shkronja "e" të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Neni 36 të Ligjit Nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligji 64/2025 "Për Barazinë Gjinore"; Ligji 9669 datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar; Ligji Nr.10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" i ndryshuar; VKM Nr.224 datë 09.04.2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror"; Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 518, datë 04.09.2018 "Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për shërbimet shoqërore", VKM nr. 823, datë 06.12.2006 "Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit", VKB Nr.79 datë 23.10.2024 "Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përfaqimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë "Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e ambienteve të Qendrës Ditore për Moshën e Tretë dhe ofrimin e shërbimeve pranë tyre", dokumenti bashkëlidhur këtij Projektvendimi.
2. Qendra Ditore për Moshën e Tretë funksionon si shërbim social në administrim të Bashkisë Përmet në dy ambiente ditore dhe ofron shërbime për të moshuarit në përputhje me standardet kombëtare të shërbimeve shoqërore.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Buxhet Financës dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë Përmet për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

ALMA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më 01.06.2026

RELACION



“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AMBIENTEVE TË QENDRËS DITORE PËR MOSHËN E TRETË DHE OFRIMIN E SHËRBIMEVE PRANË TYRE”

Në mbështetje të nenit 24 dhe 54, shkronja “e” të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Neni 36 të Ligjit Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji 64/2025 “Për Barazinë Gjinore”; Ligji 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar; Ligji Nr.10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i ndryshuar; VKM Nr.224 datë 09.04.2024 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”; Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 518, datë 04.09.2018 “Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për shërbimet shoqërore”, VKM Nr. 823, datë 06.12.2006 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit”, VKB Nr.79 datë 23.10.2024 “Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përqafimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi:

Përmbledhje Ekzekutive

Ky projekt-vendim paraqitet për miratim me qëllim aprovimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin e Ambienteve të Qendrës Ditore për Moshën e Tretë dhe Ofrimin e Shërbimeve pranë tyre.

Rregullorja përcakton kuadrin organizativ dhe administrativ të funksionimit të qendrës, procedurat e pranimin të përfituesve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, përgjegjësitë e stafit, si dhe standardet e ofrimit të shërbimeve sociale, psikosociale, rekreative, shëndetësore dhe ushqimore.

Qëllimi kryesor i këtij akti është garantimi i funksionimit të qëndrueshëm, transparent dhe në përputhje me standardet kombëtare të shërbimeve sociale për personat e moshës së tretë.

Arsyetimi

Bashkia Përmet, në kuadër të kompetencave të saj në fushën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, ka ndërmarrë masa konkrete për zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve komunitare për grupet vulnerabël.

Numri në rritje i personave të moshuar që jetojnë vetëm, përballen me izolim social, vështirësi ekonomike apo mungesë të aktiviteteve sociale dhe komunitare, evidenton nevojën për një shërbim të strukturuar dhe të organizuar sipas standardeve të përcaktuara.

Qendra Ditore për Moshën e Tretë ofron ambiente ku të moshuarit mund të marrin pjesë në aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative, të përfitojnë mbështetje psikosociale, orientim për shërbime të tjera sociale, monitorim bazë shëndetësor dhe shërbimin e vaktit ushqimor.



Miratimi i kësaj rregulloreje është i nevojshëm për të përcaktuar qartë procedurat e funksionimit të qendrës kompetencat e stafit dhe standardet e shërbimeve të ofruara. Në rrahës të këtij akti, funksionimi i qendrës do të mbështetet vetëm në dispozita të përgjithshme ligjore, pa pasur një kuadër të detajuar administrativ dhe organizativ në nivel vendor.

Përputhshmëria me Planifikimin Strategjik dhe Dokumente të Tjera

Projekt-vendimi është në përputhje me:

- Planin Social 2024–2027 të Bashkisë Përmet;
- Objektivat e politikave vendore për mbrojtjen sociale dhe përfshirjen e të moshuarve;
- Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Përmet dhe Shërbimit Social Shtetëror;
- Standardet kombëtare të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit.

Miratimi i rregullores kontribuon në përmbushjen e objektivave strategjike për rritjen e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë Përmet.

Analiza Financiare dhe Buxhetore

Zbatimi i kësaj rregulloreje mbështetet në fondet e planifikuara në buxhetin e Bashkisë Përmet për shërbimet sociale, si dhe në fondet e siguruar nga programet mbështetëse, përfshirë Fondin Social Shtetëror 2025–2027.

Miratimi i rregullores nuk krijon detyrime financiare shtesë përtej fondeve të miratuara për funksionimin e Qendrës Ditore për Moshën e Tretë.

Burimet financiare ekzistuese konsiderohen të mjaftueshme për zbatimin e dispozitave të rregullores dhe për ofrimin e shërbimeve të parashikuara në të.

Konsultimi Publik dhe Përfshirja e Palëve të Interesuara

Kjo Rregullore është hartuar në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë Përmet, stafin e shërbimeve sociale dhe partnerët institucionalë të përfshirë në zbatimin e projektit.

Gjatë hartimit janë marrë në konsideratë standardet kombëtare të shërbimeve sociale dhe nevojat e identifikuara të përfituesve të shërbimit.

Konkluzione dhe Rekomandime

Qendra Ditore për Moshën e Tretë përbën një shërbim të rëndësishëm komunitar për mbështetjen sociale, aktivizimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së personave të moshuar në territorin e Bashkisë Përmet.

Miratimi i kësaj rregulloreje krijon bazën administrative dhe organizative për funksionimin e rregullt të qendrës, garanton respektimin e standardeve ligjore dhe profesionale dhe siguron ofrimin e shërbimeve cilësore për përfituesit.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak Përmet të miratojë projekt-vendimin "Për miratimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Ambienteve të Qendrës Ditore për Moshën e Tretë dhe Ofrimin e Shërbimeve pranë tyre".

Dokumentet Bashkëlldhur

1. Projekt-vendimi.
2. Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Ambienteve të Qendrës Ditore për Moshën e Tretë.

Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit Kulturë, Sport

Arjana Papapano



Drejtoria e Projekteve dhe Integritimit Evropian

Klaudja Ciko





P/VENDIM

Nr. ___ datë ___ / ___ 2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 123 DATË 17.12.2025 «PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INDIVIDËVE PËRFITUES TË SHËRBIMIT "NJË VAKT USHQIMOR" PJESË E PROJEKTIT "PËRQAFIMI I SHPRESËS NJË OAZ PËR ATA QË KANË NEVOJË" PËR VITIN 2026».


Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore", VKB Nr.79 datë 23.10.2024 "Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përfaqimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë», VKB Nr. 123 datë 17.12.2025 "Per miratimin e listes se individeve perfitues te sherbimit "Nje vakt ushqimor" pjese e projektit "Perqafimi i shpreses nje oaz per ata qe kane nevoje" per vitin 2026". Shkresa e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 2586/1 Datë 08.04.2026, Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në listën me 50 individë përfitues të shërbimit "një vakt ushqimor" pjesë e projektit "Përfaqimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë" dhe ndryshimet në listën rezervë me individë të cilët kanë shprehur kërkesën për shërbim e cila do të merret në konsideratë (sipas prioritetit situatë sociale më në vështirësi) në rast mungese ose refuzimi në periudhat në vazhdim.

Lista si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Arsyeja e largimit	Zëvendësuar ne listën kryesore	Situata sociale
1	Fatmira Beqaraj	Refuzim	Vezire Duralliu	E moshuar e vetme. Probleme shëndetësore, komunitet egjyptian
2	Lulezim Beqaraj	Refuzim	Genti Petro	I vetmuar, probleme sociale dhe shëndetësore
3	Spartak Jemini	Nuk paraqiten	Violeta Musai	E moshuar, e vetme, vështirësi ekonomike
4	Jorgo Jemini	Nuk paraqiten	Elton Tatazi	Probleme shëndetësore, pamundësi social-ekonomike
5	Manushaqe Goxhaj	Larguar nga Përmeti	Liri Cumani	E moshuar , e vetmuar, veshitësi ekonomike
6	Ollga Meshini	Nuk paraqitet	Sotir Sfrati	I moshuar i vetmuar
7	Verore Fejzo	Nuk paraqitet	Spiro Miti	I moshuar, i vetmuar, pamundësi ekonomike



Nr	Emër Mbiemër	Arsyeja e largimit	Zëvendësuar në listen rezervë	Situata sociale
1	Luiza Titi	Refuzim	Artan Stefani	Pamundësi ekonomike dhe sociale
2	Sokol Titi	Refuzim	Robert Miti	I moshuar, i vetmuar, pamundësi ekonomike
3	Qazim Qarri	Nuk paraqitet	Engjëllushe Budo	E moshuar, sëmundje shoqëruese
4	Athina Culli	Nuk paraqitet	Polikron Budo	I moshuar, sëmundje shoqëruese
5	Myrvete Dhrami	Nuk paraqitet	Gjergji Dhëmbi	PAK, i vetmuar, vështirësi ekonomike
6	Alie Habili	Nuk paraqiten	Spiro Xhillari	Sëmundje shoqëruese
7	Valentina Habili	Nuk paraqiten	Agim Pasho	I moshuar i vetmuar, Invalid, sëmundje shoqëruese
8	Fatmir Doko	Refuzim	Tane Myftari	I moshuar i vetmuar, pamundësi ekonomike

- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sporte dhe Drejtorja e Projekteve, Integritimit Evropian, Performancës dhe Dixhitalizimit të të Dhënave.
- Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefektura.

**KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më 01.06.2026

RELACION

PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 123 DATË 17.12.2025 «PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INDIVIDËVE PËRFITUES TË SHËRBIMIT "NJË VAKT USHQIMOR" PJESË E PROJEKTIT "PËRQAFIMI I SHPRESËS NJË OAZ PËR ATA QË KANË NEVOJË" PËR VITIN 2026».

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore", VKB Nr.79 datë 23.10.2024 "Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përfaqimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë», VKB Nr. 123 datë 17.12.2025 "Per miratimin e listes se individeve perfitues te sherbimit "Nje vakt ushqimor" pjese e projektit "Perqafimi i shpreses nje oaz per ata qe kane nevoje" per vitin 2026", si dhe Shkresa e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 2586/I Datë 08.04.2026.

Hapat e ndjekur për procesin e përzgjedhjes së individëve përfitues:

1. Me nisjen e implementimit të projektit, referuar dhe zbatimit të projektit për të moshuarit që Bashkia Përmet zbatoi me UNDP, një tablo e përgjithshme e situatës dhe nevojave të komunitetit është krijuar.
2. Bashkia Përmet vijoi bashkëpunimin me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Përmet për bashkëpunimin e stafit të dy institucioneve gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit dhe jo vetëm. Fillimisht konsultimi me mjekët e familjes nga Njësia e Referimit të Rastit në Bashki për të mbledhur nevoja të tjera.
3. Gjatë aplikimit të projektit, Bashkia i është referuar situatës së Pandemisë Covid 19 dhe problematikave apo kërkesave të individëve/komunitetit, referuar Planit Social të Bashkisë Përmet 2024-2027 dhe bashkëpunimit me NJVKSH Përmet dhe mjekëve të familjeve, për kategoritë prioritet për tu mbështetur.
4. Pas disa takimeve me Grupin e Punës për zbatimin e projektit i ngitur me Urdhër Nr.46 datë 12.02.2025, Nr.422 Prot datë 12.02.2025, përcaktuam kriteret për kategoritë që do të përzgjidheshin bazuar edhe në synimin dhe objektivat e Projektit, referuar edhe Planit Social si dhe kërkesave të ardhura nga individë dhe të afërm të individëve të interesuar për të përfituar këtë shërbim, kategoria që do të ishte prioritet do të ishte:
 - Të moshuar të vetmuar që jetojnë pa asnjë të afërm pranë
 - Individë pjesë e Komunitetit Egjyptian (të vetmuar+ vështirësi ekonomike)
 - Individë që trajtohen me PAK pa mbështetje
 - Individë PAK dhe në situatë rruge
 - Individë me vështirësi ekonomike
5. Grupi i punës ka marrë në konsideratë dhe rastet e identifikuara dhe referuara nga Shërbimi Social Shtetëror sic janë familjet ekstermisht të varfra.



6. Duke marrë parasysh që shërbimi do të ofrohet në ambientin ditor pranë Konviktit Përmet, lista e përfituesve do të fokusohet për kategoritë në nevojë që jetojnë në qytet.
7. Referuar projektit "Të moshuar jo të vetmuar, aktiv dhe të lumtur" i cili përfundoi zbatimin në fillim të muajit Maj 2025, Grupi i punës në Bashki, konsultoi listën e mbetur duke shtuar edhe disa prej të moshuarve që bënin pjesë në projektin e parë.
8. Shërbimi i ofrimit të vaktit ushqimor për vitin 2025, nisi zbatimin në muajin Nëntor 2025 dhe mbulohej 100% nga fondet e dedikuara të projektit nga Fondi Social deri në 31 Dhjetor 2025.
9. Për vitin 2026 rritet pjesa e bashkëfinancimit të bashkisë konkretisht 60% Fondi Social dhe 40% financim i bashkisë.

Duke marrë në konsideratë ecurinë e shërbimit të ofrimit të vaktit ushqimor në vitin 2025, është menduar një rishikim i listës së përfituesve pasi shërbimi në banesë i tejkalon kapacitetin financiar dhe burimet njerëzore të dedikuara për shërbimin në familje. Për vitin 2026 shërbimi do të ofrohet vetëm pranë Qendrës Ditore për të moshuarit, ambientit të dedikuar për zbatimin e projektit. Referuar VKB Nr. 123 datë 17.12.2025 lista e përfituesve ka marrë shërbim prej datës 2 Prill, datë e cila përkon me fillimin e shërbimit "Një vakt ushqimor" për vitin 2026.

Prej kësaj liste disa individë nuk paraqiten për të marrë shërbim për arsye refuzimi nga ana e tyre apo për largim nga qyteti. Të gjitha këto bëjnë që individët të zëvendësohen me përfitues të tjerë të cilët kanë shprehur kërkesën pranë Qendrës së të moshuarve ose pranë Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashki.

Kjo do të sillte qëndrueshmëri të projektit por kryesisht mbështetje për të moshuarit dhe individët në kushte të vështira social-ekonomike që është dhe qëllimi kryesor i projektit.

Gjithashtu po ju njohim dhe me një listë rezerve me individë të cilët kanë shprehur kërkesën për shërbim e cila do të merret në konsideratë (sipas prioritetit situatë sociale më në vështirësi) në rast mungese ose refuzimi në periudhat në vazhdim:

Konsultimi përfundimtar arriti në emrat e mëposhtëm:

Nr	Emër Mbiemër	Arsyeja e largimit	Zëvendësuar ne listën kryesore	Situata sociale
1	Fatmira Beqaraj	Refuzim	Vezire Duralliu	E moshuar e vetme. Probleme shëndetësore, komunitet egjyptian
2	Lulezim Beqaraj	Refuzim	Genti Petro	I vetmuar, probleme sociale dhe shëndetësore
3	Spartak Jemini	Nuk paraqiten	Violeta Musai	E moshuar, e vetme, vështirësi ekonomike
4	Jorgo Jemini	Nuk paraqiten	Elton Tatazi	Probleme shëndetësore, pamundësi social-ekonomike
5	Manushaqe Goxhaj	Larguar nga Përmeti	Liri Cumani	E moshuar, e vetmuar, vështirësi ekonomike
6	Ollga Meshini	Nuk paraqitet	Sotir Sfrati	I moshuar i vetmuar

Sheshi "Abdyl Frashëri", tel.+35581322254,e-mail:info@bashkiapermet.gov.al



Nr	Emër Mbiemër	Arsyeja e largimit	Zëvendësuar në listën rezervë	Situata sociale
7	Verore Fejzo	Nuk paraqitet	Spiro Miti	I moshuar, i vetmuar, pamundësi ekonomike
1	Luiza Titi	Refuzim	Artan Stefani	Pamundësi ekonomike dhe sociale
2	Sokol Titi	Refuzim	Robert Miti	I moshuar, i vetmuar, pamundësi ekonomike
3	Qazim Qarri	Nuk paraqitet	Engjëllushe Budo	E moshuar, sëmundje shoqëruese
4	Athina Culli	Nuk paraqitet	Polikron Budo	I moshuar, sëmundje shoqëruese
5	Myrvete Dhrami	Nuk paraqitet	Gjergji Dhëmbi	PAK, i vetmuar, vështirësi ekonomike
6	Alie Habili	Nuk paraqiten	Spiro Xhillari	Sëmundje shoqëruese
7	Valentina Habili	Nuk paraqiten	Agim Pasho	I moshuar i vetmuar, Invalid, sëmundje shoqëruese
8	Fatmir Doko	Refuzim	Tane Myftari	I moshuar i vetmuar, pamundësi ekonomike

Kjo është lista përfundimtare e rishikuar për miratim nëse nuk do të ketë sugjerime nga Komisioni i Përkrahjes Sociale apo antarët e Këshillit Bashkiak.

Faleminderit
Drejtorja e Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sporte
Arjana Papapano

Drejtorja e Projekteve të Huaja/ Integritimit Evropian / Performancës dhe Dixhitalizimit të të dhënave

Klaudja Ciko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2026

PËR

**"DHËNIEN NË PËRDORIM TË STADIUMIT "DURIM QYPI" DHE AMBIENTEVE
NDIHMËSE TË TIJ NGA ANA E BASHKISË PËRMET PËR OJF-NË "KLUBI I
FUTBOLLIT PËRMET".**

Mbështetur në nenet 54 dhe 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenin 304 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 79/2017 "Për Sportin", LIGJ Nr.8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, VKM nr. 1032, datë 08.10.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Përmet, të Qarkut të Gjirokastrës", Vendimin e Këshillit Bashkiak Përmet nr. 88, datë 05.11.2024 "Për themelimin e Shoqatës Klubi i Futbollit Përmet", Vendimin e Këshillit Bashkiak Përmet nr. 52, datë 02.06.2025 "Për miratimin e Statutit dhe Aktit të Themelimit të Shoqatës Klubi i Futbollit Përmet", Vendimin nr. 7707, datë 05.03.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për regjistrimin e OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet", si dhe kërkesën e OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet",

VENDOSI

1. T'i jepet në përdorim OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet" Stadiumi "Durim Qypi" dhe ambientet ndihmëse të tij, pasuri në pronësi të Bashkisë Përmet me nr. pasurie 19/5 dhe 19/6, sipas listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi të Bashkisë Përmet me VKM nr. 1032, datë 08.10.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Përmet, të Qarkut të Gjirokastrës", për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë sportive të futbollit, pa pagesë.
2. OJF-ja "Klubi i Futbollit Përmet" do të përdorë fushën e futbollit dhe ambientet ndihmëse vetëm për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj sportive.
3. Përdorimi i stadiumit dhe ambienteve ndihmëse jepet pa të drejtë ekskluzive. Bashkia Përmet ruan të drejtën e përdorimit dhe të vënies në dispozicion të objektit për aktivitete të tjera publike, sportive ose institucionale.
4. Përdorimi i objektit do të vazhdojë për aq kohë sa OJF-ja "Klubi i Futbollit Përmet" ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë Përmet dhe strukturat përkatëse të administratës së Bashkisë.
6. Ky vendim, pas miratimit nga ana e këshillit Bashkiak Përmet, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI BASHKISË

Ajma HUXHA

Sheshi "AbdylFrashëri" ;tel +35581322254 e-mail: info@bashkiapermet.gov.al www.bashkiapermet.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

RELACION

"PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË STADIUMIT 'DURIM QYPI' DHE AMBIENTEVE NDIHMËSE OJF-SË 'KLUBI I FUTBOLLIT PËRMET'"

Këshillit Bashkiak Përmet i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi "Për dhënie në përdorim të Stadiumit 'Durim Qypi' dhe ambienteve ndihmëse OJF-së 'Klubi i Futbollit Përmet'".

Bashkia Përmet, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 88, datë 05.11.2024, ka themeluar Shoqatën "Klubi i Futbollit Përmet". Më pas, me Vendimin nr. 52, datë 02.06.2025, Këshilli Bashkiak ka miratuar Statutin dhe Aktin e Themelimit të kësaj shoqate. Shoqata është regjistruar si Organizatë Jofitimprurëse me Vendimin nr. 7707, datë 05.03.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Sipas Statutit të saj, OJF-ja "Klubi i Futbollit Përmet" ka për qëllim zhvillimin e veprimtarisë sportive futbollistike, rritjen e cilësisë sportive, masivizimin e futbollit, krijimin dhe vazhdimësinë e ekipeve të moshave, organizimin e aktiviteteve sportive në rang kombëtar, promovimin e futbollit dhe përfaqësimin e qytetit të Përmetit në aktivitetet sportive. Gjithashtu, selia e shoqatës është përcaktuar pranë Stadiumit "Durim Qypi".

Për realizimin e objektivave statutores dhe për garantimin e ushtrimit normal të veprimtarisë sportive, është e nevojshme që OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet" t'i jepet në përdorim Stadiumi "Durim Qypi" dhe ambientet ndihmëse të tij.

Stadiumi "Durim Qypi" dhe ambientet përkatëse përbëjnë pasuritë me nr. 19/5 dhe nr. 19/6, të transferuara në pronësi të Bashkisë Përmet me VKM nr. 1032, datë 08.10.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Përmet, të Qarkut të Gjirokastrës".

Dhënia në përdorim e stadiumit nuk ndryshon regjimin e pronësisë së pasurisë, e cila mbetet në pronësi të Bashkisë Përmet, por synon krijimin e kushteve të nevojshme për zhvillimin e sportit, aktivizimin e të rinjve, përfaqësimin dinjitoz të qytetit në aktivitetet futbollistike dhe nxitjen e aktiviteteve sportive në komunitet.

OJF-ja "Klubi i Futbollit Përmet" do të jetë përgjegjëse për administrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të marra në përdorim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e përcaktuara në marrëveshjen që do të lidhet me Bashkinë Përmet. Për sa më sipër, vlerësohet i nevojshëm dhe në interes publik miratimi i projekt-vendimit "Për dhënie në përdorim të Stadiumit 'Durim Qypi' OJF-së 'Klubi i Futbollit Përmet'".

Konceptoi: Zyra Juridike

K.Lile





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KRYETARI

P/VENDIM

Nr. ___ datë ___ / ___ 2026

PËR

**MBËSHTETJEN FINANCIARE TË AKTIVITETEVE SPORTIVE PËR VITIN 2026 TË
SHOQATËS "KLUBI I FUTBOLLIT PËRMET"**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9, neni 25 pika 4, i ndryshuar; Ligjit 79/2017 «Për Sportin» neni 21; VKB Nr.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Përmet për vitin 2026"; Ligji 8788 datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse"; Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligji nr. 80/2021, "Për rregjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", i ndryshuar me Ligji Nr.90 /2025; Vendim Nr.7707 datë 05.03.2026 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë "Për themelimin e shoqatës "Klubi i Futbollit Përmet"; Kërkesa Nr.1938 Datë 02.06.2026 e Shoqatës Klubi Futbollit Permet; Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë mbështetjen financiare për aktivitetet sportive të shoqatës "Klubi Futbollit Përmet" për vitin 2026 në vlerën 2 000 000 lekë sipas kërkesave buxhetore të paraqitura nga shoqata me Kërkesë Nr.1938 Datë 02.06.2026.
2. Mbështetja për realizimin e aktiviteteve do të jetë sipas planifikimeve buxhetore ne buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2026, struktura buxhetore: AD135.V813AAB.604.Kap05.
3. Shpenzimet për aktivitetet e shoqatës do të mbulohen nga data e themelimit të saj me Vendim Gjykatë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sport dhe Drejtoria e Buxhet Financës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

ALMA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më 01.06.2026

RELACION

PËR

MBËSHTETJEN FINANCIARE TË AKTIVITETEVE SPORTIVE PËR VITIN 2026 TË SHOQATËS "KLUBI I FUTBOLLIT PËRMET"

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9, neni 25 pika 4, i ndryshuar; Ligjit 79/2017 «Për Sportin» neni 21; VKB Nr.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Përmet për vitin 2026"; Ligji 8788 datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse"; Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligji nr. 80/2021, "Për rregjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", i ndryshuar me Ligji Nr.90 /2025; Vendim Nr.7707 datë 05.03.2026 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë "Për themelimin e shoqatës "Klubi i Futbollit Përmet"; Kërkesa Nr.1938 Datë 02.06.2026 e Shoqatës Klubi Futbollit Përmet; paraqesim ProjektVendimin për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Përmet me qëllim mbështetjen financiare të Shoqatës "Klubi i Futbollit Përmet" viti 2026.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky projekt-vendim synon miratimin e mbështetjes financiare për Shoqatën "Klubi i Futbollit Përmet" në vlerën 2,000,000 (dy milion) lekë, për përballimin e shpenzimeve të realizuara gjatë periudhës Mars–Maj 2026, në kuadër të zhvillimit të aktivitetit sportiv. Shoqata përfaqëson Bashkinë Përmet në aktivitetet sportive dhe kontribuon në promovimin e sportit, aktivizimin e të rinjve dhe përfshirjen e komunitetit në veprimtari sportive.

Qëllimi kryesor i projekt-vendimit është garantimi i vazhdimësisë së aktivitetit sportiv të klubit dhe mbështetja e zhvillimit të sportit në territorin e Bashkisë Përmet.

ARSYETIMI

Shoqata "Klubi i Futbollit Përmet" është regjistruar si person juridik më datë 05.03.2026 dhe ka zhvilluar aktivitet sportiv të rregullt gjatë sezonit Mars–Maj 2026. Për realizimin e aktiviteve sportive janë kryer shpenzime të domosdoshme operative dhe organizative, të dokumentuara në kërkesën dhe dokumentacionin financiar të paraqitur pranë Bashkisë Përmet.

Mbështetja financiare është e nevojshme për:

- a) garantimin e vijimësisë së aktivitetit sportiv;
- b) përfaqësimin e Bashkisë Përmet në aktivitetet sportive;



- c) nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në sport;
- d) promovimin e vlerave sportive dhe jetesës aktive.

Pasojat në rast mosmiratimi të projekt-vendimit do të ishin mungesa e mbështetjes financiare për aktivitetet e zhvilluara, vështirësi në vijimësinë e klubit dhe reduktim i mundësive për zhvillimin e sportit në nivel vendor.

PËRPUTHSHMËRIA ME PLANIFIKIMIN STRATEGJIK DHE AKTE TË TJERA

Projekt-vendimi është në përputhje me:

- funksionet e Bashkisë të përcaktuara në Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore";
- Ligjin nr.79/2017 "Për Sportin";
- Programin buxhetor të Bashkisë Përmet për mbështetjen e aktiviteteve sportive;
- objektivat e zhvillimit social dhe rinor të Bashkisë Përmet.

Mbështetja e aktiviteteve sportive kontribuon në realizimin e politikave vendore për promovimin e sportit dhe angazhimin e të rinjve.

ANALIZA FINANCIARE DHE BUXHETORE

Vlera e financimit të propozuar është: **2,000,000 (dy milion) lekë.**

Financimi do të realizohet nga fondet e miratuara në buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2026, në strukturën buxhetore: **AD135.V813AAB.604, Kap05** sipas fondeve të parashikuara për mbështetjen e aktiviteteve sportive. Detajet e shpenzimeve sipas kërkesës:

Nr.	Përshkrimi i shpenzimit	Vlera (lekë)
1	Trajtim ushqimor për 8 ndeshje Mars-Maj 2026	1,421,126
2	Pagë Drejtor Ekzekutiv (3 muaj)	133,200
3	Sigurime shoqërore Dr.Ekzekutiv	41,850
4	Pagë Trajneri (3 muaj)	120,000
5	Pagë Financieri (3 muaj)	90,000
6	Tatim në burim	34,674
7	Shërbime mjekësore për ndeshjet	54,000
8	Analiza mjekësore të sportistëve	75,000
9	Regjistrim i shoqatës dhe shërbime elektronike	30,000
Totali		2,000,000

Zbatimi i vendimit nuk krijon detyrime financiare shtesë jashtë fondeve të planifikuara në buxhetin vendor. Rreziku financiar konsiderohet i ulët, pasi fondi është i planifikuar në buxhet dhe përdorimi i tij do të monitorohet nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë.

KONSULTIMI PUBLIK DHE PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESUARA



Projekt-vendimi është hartuar mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga Shoqata "Klubi i Futbollit Përmet" dhe dokumentacionit shoqëruar të miratuar nga organet drejtuese të saj. Për shkak të natyrës individuale të aktit dhe faktit që nuk krijon norma të përgjithshme për publikun, nuk është objekt i konsultimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se Shoqata "Klubi i Futbollit Përmet" përmbush kushtet ligjore për përfitimin e mbështetjes financiare. Financimi i propozuar mbështet zhvillimin e sportit, promovimin e vlerave sportive dhe përfaqësimin e Bashkisë Përmet në veprimtaritë sportive.

Për këto arsye rekomandohet miratimi i projekt-vendimit nga Këshilli Bashkiak Përmet.

DOKUMENTET BASHKËLIDHUR

1. Certifikata e regjistrimit.
2. Vendimi i Gjykatës për regjistrimin e shoqatës.
3. Projekt-vendimi për shqyrtim dhe miratim.

Faleminderit
Drejtoria e Shërbimit Social, Arsim, Kulturë, Sport

Arjana Papapano

Drejtoria e Projekteve, Integritimit Evropian, Performancës dhe Dixhitalizimit të të dhënave

Klaudja Ciko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2026

PROJEKTVENDIM

"Për miratimin e formës së organizimit të aktivitetit futbollistik nëpërmjet OJF-së 'Klubi i Futbollit Përmet' dhe miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave".

Në mbështetje të neneve 54 dhe 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, nenit 304 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 125/2020 "Për Sportin", të ndryshuar, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Përmet nr. 88, datë 05.11.2024 "Për themelimin e Shoqatës Klubi i Futbollit Përmet", Vendimit të Këshillit Bashkiak Përmet nr. 52, datë 02.06.2025 "Për miratimin e Statutit dhe Aktit të Themelimit të Shoqatës Klubi i Futbollit Përmet", Vendimit nr. 7707, datë 05.03.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për regjistrimin e OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet", si dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Përmet, Këshilli Bashkiak

VENDOSI:

1. Të miratojë organizimin dhe zhvillimin e aktivitetit futbollistik në territorin e Bashkisë Përmet nëpërmjet organizatës jofitimprurëse "Klubi i Futbollit Përmet", të themeluar nga Bashkia Përmet dhe të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të miratojë formën e bashkëpunimit institucional ndërmjet Bashkisë Përmet dhe OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet", me qëllim zhvillimin, administrimin dhe promovimin e aktivitetit futbollistik në territorin e Bashkisë Përmet.
3. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave ndërmjet Bashkisë Përmet dhe OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të autorizojë Kryetaren e Bashkisë Përmet për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe të çdo akti tjetër administrativ të nevojshëm për zbatimin e saj.
5. Financimi i OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet" të realizohet në përputhje me fondet e miratuara në buxhetin e Bashkisë Përmet dhe sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit.



6. OJF-ja "Klubi i Futbollit Përmet" është e detyruar të përdorë fondet vetëm për realizimin e objektivave sportive, të mbajë evidencë të plotë financiare dhe të raportojë periodikisht pranë Bashkisë Përmet mbi përdorimin e fondeve dhe realizimin e aktiviteteve sportive.

7. Ngarkohen Drejtoria e Financës, Sektori Juridik dhe strukturat e tjera përgjegjëse të Bashkisë Përmet për zbatimin e këtij vendimi.

8. Ky vendim, pas miratimit nga ana e këshillit Bashkiak Përmet, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI I BASHKISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

RELACION

PËR MIRATIMIN E FORMËS SË ORGANIZIMIT TË AKTIVITETIT FUTBOLLISTIK NËPËRMJET OJF-SË "KLUBI I FUTBOLLIT PËRMET" DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT DHE MENAXHIMIT TË TË ARDHURAVE NDËRMJET BASHKISË PËRMET DHE OJF-SË "KLUBI I FUTBOLLIT PËRMET"

Këshillit Bashkiak Përmet i paraqitet për shqyrtim dhe miratim forma e organizimit të aktivitetit futbollistik në territorin e Bashkisë Përmet nëpërmjet organizatës jofitimprurëse "Klubi i Futbollit Përmet", si dhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave që do të lidhet ndërmjet Bashkisë Përmet dhe kësaj organizate.

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë ndër funksionet e tyre mbështetjen dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive, krijimin e kushteve për promovimin e sportit dhe administrimin e infrastrukturës sportive në interes të komunitetit. Gjithashtu, Ligji nr. 125/2020 "Për Sportin", i ndryshuar, parashikon mundësinë e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive nëpërmjet organizatave sportive të krijuara sipas legjislacionit në fuqi.

Në këtë kuadër, Këshilli Bashkiak Përmet me Vendimin nr. 88, datë 05.11.2024 ka miratuar themelimin e Shoqatës "Klubi i Futbollit Përmet". Në vijim, me Vendimin nr. 52, datë 02.06.2025 është miratuar Akti i Themelimit dhe Statuti i organizatës, duke përcaktuar mënyrën e organizimit, organet drejtuese, objektivat dhe veprimtarinë e saj.

Pas përmbushjes së procedurave ligjore, organizata jofitimprurëse "Klubi i Futbollit Përmet" është regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 7707, datë 05.03.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Më pas është kryer regjistrimi pranë organeve tatimore, pajisja me NIPT dhe hapja e llogarive bankare për ushtrimin e aktivitetit financiar dhe administrativ sipas legjislacionit në fuqi.

Krijimi i kësaj organizate synon të sigurojë një formë më të specializuar dhe efektive të administrimit të aktivitetit futbollistik, duke mundësuar menaxhimin e veprimtarisë sportive në përputhje me kërkesat e Federatës Shqiptare të Futbollit, legjislacionin sportiv dhe rregullat e administrimit financiar të organizatave sportive.

Për realizimin e objektivave të saj, OJF-ja "Klubi i Futbollit Përmet" ka paraqitur kërkesë për bashkëpunim dhe mbështetje financiare nga Bashkia Përmet. Në këtë kuadër është hartuar Marrëveshja e Bashkëpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, mënyrën e transferimit të fondeve, destinacionin e përdorimit të tyre, procedurat e raportimit, monitorimit dhe kontrollit.



Nëpërmjet kësaj kontrate synohet që fondet publike të përdoren ekskluzivisht për realizimin e aktiviteteve sportive, përfshirë pagesat për stafin teknik, pjesëmarrjen në aktivitete sportive, transportin dhe akomodimin e ekipeve, blerjen e pajisjeve sportive, organizimin e aktiviteteve futbolistike dhe shpenzime të tjera të nevojshme për funksionimin e klubit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe objektivat e organizatës.

Për të garantuar ligjshmërinë, transparencën dhe përdorimin e rregullt të fondeve publike, kontrata parashikon detyrimin e OJF-së për të mbajtur evidencë të plotë financiare, për të paraqitur raporte periodike mbi të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe për të vënë në dispozicion të Bashkisë çdo dokumentacion të kërkuar.

Gjithashtu, propozohet që monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të kontratës të realizohet nga një grup monitorimi i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, i përbërë nga punonjës të administratës së Bashkisë Përmet. Ky grup do të verifikojë përdorimin e fondeve, përputhshmërinë e shpenzimeve me qëllimin e financimit, dokumentacionin justifikues dhe realizimin e aktiviteteve sportive të financuara. Rezultatet e monitorimit do të dokumentohen në raporte periodike dhe, kur të jetë e nevojshme, do t'u paraqiten organeve drejtuese të Bashkisë.

Miratimi i formës së organizimit të aktivitetit futbolistik nëpërmjet OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet" dhe i Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave krijon bazën institucionale dhe ligjore për funksionimin e klubit, mbështetjen financiare të tij dhe garantimin e mekanizmave të kontrollit mbi përdorimin e fondeve publike.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak Përmet të miratojë formën e organizimit të aktivitetit futbolistik nëpërmjet OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet", Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave ndërmjet Bashkisë Përmet dhe OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet", si dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin dhe zbatimin e saj.

Konceptoi: Zyra Juridike

K.Lile





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____, 2026

P/VENDIM

Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmës ekonomike, deri në 6% .

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmen dhe shërbimet shoqerore " i ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 "Për disa ndryshime në Vendimin 597 dt.04.09.2019 të K.M."Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtese,mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.617,date 22.09.2022 i përditësuar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Përmet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi të saj". Keshilli Bashkiak, me propozim të Kryetares së Bashkisë:

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për Muajn Prill 2026, 5 familje me një fond prej 17.481 lekë.
2. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atësia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma
1	Roland Petraq Jorgji	Divorcuar	1	2.178
2	Lame Enver Ferati	Silvana Kujtim Ferati	3	5.227
3	Mimoza Skënder Gjoka	Divorcuar	1	2.178
4	Lefteri Mihal Tyto	Divorcuar	1	5.720
5	Flavia Musa Pelushaj	Beqare	1	2.178
	SHUMA			17.481

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmës ekonomike.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetqeverisjen Vendore", (i ndryshuar).

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më ____ . ____ .2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËS
EKONOMIKE, DERI NË 6% .

Mbështetur në Ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" Ligji 935 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar me VKM Nr.955 datë 07.12.2016(kreu II pika 13) dhe udhëzimi nr.5 datë 17.02.2017 pika 2 i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.Për përcaktimin kriterëve,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike si dhe VKM nr.85 dat 10.02.2021,nr.868,datë 29.12.2021;n.617,datë 22.09.2022 i përditësuar Vendimi i,Këshillit Bashkiak Përmet me fonde të Buxhetit Vendor Nr.113 datë 17.12.2025"Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë,institucioneve në varësi të saj "Këshilli Bashkiak ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike familjet aplikuese që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,deri 6% të bllok ndihmës ekonomike të muajit.Prill 2026 me Vendim të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Gjirokastër.Nr.10/2022 datë 27/10/2022 për dhënien e NE për periudhën 01-30-2026 Për Bashkinë Përmet.(Sipas vendimit të Muajit Prill 2026).

Për sa më sipër vlera e fondit të kushtëzuar (bllok ndihma ekonomike) për Muajin Prill 2026

është 45 familje me,Shumën prej 330.196 lekë dhe për tu trajtuar familje me ndihmë ekonomike janë në dispozicion 6% e këtij fondi ose 19.812 lekë,për Muajin Prill 2025.

Mbështetur në të dhënat për dhënien e Ndihmës Ekonomike për periudhën 1-30 Prill 2026 kanë aplikuar 7 familje asedhenjë familje nuk ka dalë fituese 45 janë përfituese në skemën e Ndihmës Ekonomike.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikuesve që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme për periudhën 01 Prill deri më datën 30 nga vlerësimi i SH.S.SH rekomandojmë:

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar prej 6%,5 familje me një vlerë 17.581 lekë,nga ku fondi 6% në total sipas vendimit është në Shumën 19.812 lekë diferenca prej 2.231 lekë do të mbetet e papërdorur për muajin Prill .

Specialisti i NE

Jurigen SIMONE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më ____ . ____ .2026

P/VENDIM

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJ
MAJ 2026**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike",VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,date 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.113 datë 17.12.2025 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj "Keshilli Bashkiak me propozim te Kryetarit te Bashkise:

VENDOSI

1.Të përfitojne ndihme ekonomike për Muajn MAJ 2026, 34 familje me një fond 127.100 lekë.

2.Fondet të përballohen nga struktura :

1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.05.Art.606.Kod produkti V043AAD per shumen 127.100 lekë

3. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma/leke
1	Ziso Apostol Kristo	Valentina Polikron Kristo	3	4200
2	Xhilda Xhemal Selimllari	Xhilda Xhemal Selimllari	2	3600
3	Mitro Gani Zeqiri	Lefteri Rrapi Zeqiri	4	4700
4	Syrja Mehmet Hoxha	Beqar	1	3200
5	Drita Irakli Kosta	Divorcuar	2	3600
6	Lefteri Polikron Proko	E ve	1	3200
7	Andon Dhimitraq Kukureci	I ve	2	3600
8	Aferdita Nuredin Lahe	Beqare	1	3200
9	Arben Thoma Teka	Mirela Xheli Teka	6	5400
10	Viktor Josif Proko	Divorcuar	1	3200
11	Dhimo Naun Dimçi	Lindita Hysen Dimçi	3	4200
12	Vera Thanas Naqe	E ve	2	3600
13	Leonart Petro Markaj	Kristina Petraq Markaj	3	4200

Sheshi "Abdyl Frashëri";tel.+35581322254;

e-mail: info@bashkiapermet.gov.al

14	Thoma Aristidh Ilia	Maria Nuredin Ilia	4	4700
15	Xhensila Maksim Jahhaj	Beqare me Femijë	2	3600
16	Violeta Guce Pelushi	Beqare	1	3200
17	Engjellushe Manxho Canollari	E ve	1	3200
18	Rivelino Fatmir Doko	Hurma Leonidha Doko	4	4700
19	Bajame Fari Hysenshahaj	E ve	1	3200
20	Lida Koco Thomollari	Divorcuar	1	3200
21	Vasilika Bedri Malka	E ve	2	3600
22	Ilir Sali Jashari	Beqar	1	3200
23	Vitori Llazo Caci	Beqare	2	3600
24	Luam Ferit Zeneli	Gezime Tafil Zeneli	4	4700
25	Ilber Kudret Dalipaj	Divorcuar	1	3200
26	Kastriot Kristo Koto	Kastriot Kristo Koto	3	4200
27	Kastriot Astrit Male	Divorcuar	1	3200
28	Vangjush Thanas Mamillo	Gentiana Seit Mamillo	3	4200
29	Bari Avni Zaimi	Valbona Zenel Zaimi	2	3600
30	Kadri Petrit Maska	Beqar	1	3200
31	Dashnor Guçe Pelushaj	Vezire Ali Pelushaj	4	4700
32	Klodiana Kristofor Peçi	Divorcuar	1	3200
33	Lulëzim Barjam Beqari	Divorcuar	1	3200
34	Ylli Guçe Pelushaj	Zylkade Qerim Pelushaj	2	3600
	SHUMA			127.100

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim –Taksa/Spektori i Buxhet Financës.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6,të nenit 55,të ligjit nr.139/2015,"Për vetqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më ____ . ____ .2026

RELACION

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI
MAJ 2026**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë.20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe shërbimet shoqerore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike",VKM Nr.617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit të punojësve të bashkisë, institucioneve në varësi të saj.Familje të cilat janë përfituese në fondin e bashkisë janë ato familje të cilat mbasi kanë bërë aplikimin në Sistemin e Ndihmës ekonomike, rekomandimin në fondin 6% nuk janë fituese. Dhe nga vizitat e kryera në familje nga Administratorët shoqëror duke parë gjëndjen ekonomike të këtyre familjeve të cilat janë në gjëndje të dobët ekonomike u arsyetua që të përfshihen në fondin e familjeve në nevojë.Për muajin Maj 2026 do të shtohet një familje me dy antarë Ylli Guçe Pelushaj dhe Zylkade Qerim Pelushaj e cila ishte në fondin 6%për arsye të rënies të numrit të familjeve në Sistemin e Pikëzimit kemi dhe rënien e fondit 6% ku nuk mund të bëhej rekomandimi i kësaj familje në këtë fond. U arsyetua që kjo familje të rekomandohet në fondin e familjeve në nevojë.

Përsa më sipër rekomandojmë të ndihmohen për muajin Maj 34 familje me një vlerë prej 127.100 lekë.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI

